



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 139

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 27 shtator 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i përbashkët i ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe i ministrit të Drejtësisë nr. 234, datë 10.9. 2018	Për shkëmbimin e informacionit mbi pasuritë e paluajtshme të regjistruara dhe tjetërsimin e tyre..... 9401
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 177, datë 20.8.2018	Për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”..... 9401
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 178, datë 20.8.2018	Për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a., në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”..... 9403
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 179, datë 20.8.2018	Për një shtesë në vendimin nr. 97, datë 23.4.2018, “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., për vitin 2018”..... 9404
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 180, datë 20.8.2018	Mbi licencimin e shoqërisë “Alesio–2014” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Fushë-Arrëz”, me fuqi të instaluar 1990 kw..... 9405
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 181, datë 20.8.2018	Mbi miratimin e planit të investimeve të shoqërisë OSHEE sh.a., për vitin 2018..... 9406
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 182, datë 20.8.2018	Mbi miratimin e planit të zhvillimit të Rrjetit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, për periudhën 5-vjeçare (2018–2022)..... 9411

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 183, datë 20.8.2018	Mbi miratimin e licencës së operimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.....	9415
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 184, datë 20.8.2018	Mbi miratimin e “Kontratës për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese), të sistemit elektroenergetik, për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018”, midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.....	9428
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 185, datë 20.8.2018	Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës nr. 73, seria FK08, të shoqërisë “Gen–I Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	9439
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 186, datë 20.8.2018	Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës nr. 74, seria T08P, të shoqërisë “Gen–I Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	9440
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 187, datë 20.8.2018	Mbi refuzimin për licencim të shoqërisë “Oberald Energjitik” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Kryezi 3”, me fuqi të instaluar 122.2 kw, “Kryezi 4”, me fuqi të instaluar 310.7 kw dhe “Kryezi 5”, me fuqi të instaluar 886.5 kw, me fuqi totale 1320 kw.....	9441
Vendim qarkullues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 21, datë 14.9.2018	Për përjashtimin nga skema dhe revokimin e certifikatës së sigurimit të depozitave të Bankës Veneto sh.a., të përthithur nga Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a.....	9442
Vendim qarkullues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 22, datë 14.9.2018	Për përjashtimin nga skema dhe revokimin e certifikatës së sigurimit të depozitave të Bankës NBG Albania sh.a., të përthithur nga Banka Amerikane e Investimeve sh.a.....	9443

**URDHËR I PËRBASHKËT****Nr. 234, datë 10.9.2018****PËR SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT
MBI PASURITË E PALUAJTSHME TË
REGJISTRUARA DHE TJETËRSIMIN
E TYRE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 273, datë 16.5.2018, “Për krijimin e regjistrit qendror të bazës së të dhënave për llogaritjen e taksës vendore të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë” (kadastra fiskale)”,

URDHËROJMË:

1. Në kuadër të krijimit të regjistrit të bazës së të dhënave për llogaritjen e taksës vendore të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Drejtoria e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë, të realizojnë shkëmbimin e informacionit mbi pasuritë e paluajtshme të regjistruara, pasuritë e paluajtshme të legalizuara dhe në proces legalizimi ose jo, si dhe informacionin e plotë mbi tjetërsimin e tyre.

2. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të vendosë në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë dhe të mundësojë marrjen e vazhdueshme të tyre brenda çdo tremujori të dhënat identifikuese të pasurisë (zona kadastrale, numri i pasurisë, adresa, volumi, faqja etj.), përshkrimin e pasurisë (sipërfaqja e ndërtuar, lloji i pasurisë etj.), pronësinë (emri/at i/e pronarëve), si dhe në mënyrë specifike vlerën e transaksionit dhe datën e kryerjes së tij në rastin e shitblerjes së pasurisë.

3. Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale të vendosë në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë të dhënat që disponon mbi pasuritë e paluajtshme “ndërtesë” për qëllim të taksës së pasurisë dhe të mundësojë marrjen e tyre.

4. Informacioni i mësipërm t’i vihet në dispozicion Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Agjencia e Legalizimit

Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale në format elektronik kur ai disponohet për një pasuri ose në rrugë shkresore.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë garanton marrjen e të dhënave dhe përdorimin e tyre vetëm për qëllime të taksës së pasurisë.

6. Ngarkohen Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE DHE
EKONOMISË
Arben Ahmetaj

MINISTRI I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj

VENDIM**Nr. 177, datë 20.8.2018****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
E BORDIT TË ERE-s NR. 187, DATË
10.11.2017, “Për LICENCIMIN E
SHOQËRISË “ALBGAZ” SHA NË
AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES
SË GAZIT NATYROR”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; i ndryshuar, nenit 3, pika 50; nenit 22, pika 2, gjerat “a” dhe “b”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; nenit 113, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; nenit 4, pika 1, gjerat “a” dhe “b”; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.8.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 187, datë 10.11.2017, licencoi shoqërinë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror.

- Sa më sipër, shoqëria “Albgaz” sh.a. brenda një afati 6-mujor në mbështetje të nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”,



kishte detyrimin për të plotësuar të gjithë dokumentacionin e munguar si më poshtë:

- dokumentacioni që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka, për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar;

- lejet dhe autorizimet mjedisore;

- një certifikatë sigurimi nga shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri), që evidenton mbulimin e përgjegjësisë për dëmtimet për plagosje, sëmundje ose raste të vdekjes së personave ose për humbjen ose shkatërrimin e pronës të shkaktuara ose që kanë rezultuar prej aktiviteteve të aplikantit në kuadër të licencës së kërkuar në një nivel përgjegjësie jo më të vogël se 10 milionë USD;

- plan biznesi;

- volumet e projektuara ditore për t'u përpunuar sipas vlerësimeve të aplikantit;

- programin e punës për zbatimin e projektit dhe jeta e pritshme e projektit,

- programi i parashikuar i mirëmbajtjes së sistemit të shpërndarjes;

- sasia mesatare e gazit natyror që parashikohet për t'u shpërndarë gjatë një viti mbështetur në një program tipik mujor.

- Në vijim të sa më sipër, ERE, me shkresën nr. 521/10 prot., datë 23.11.2017, bëri me dije shoqërinë “Albgaz” sh.a. për vendimarrjen e sipërcituar, mungesën e dokumentacionit dhe kushteve të vendosura në dispozitivin e vendimit për plotësimin e dokumentacionit të munguar brenda afateve të përcaktuara.

- Në përgjigje të korrespondencës sipërcituar të ERE-s, shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 38/1, datë 14.5.2018, ka informuar ERE mbi përditësimin e procedurave të dokumentacionit si më poshtë:

- pajisja me certifikatë pronësie (Sheq i Madh, Fier–Drizë, Fier–Gjonçë, Lavdan);

- procedurat në vijimësi për certifikatat në Cërrik, Drenovë dhe Balldren.

- Sa më sipër, “Albgaz” sh.a. informon ERE se ka bërë kërkesë pranë ZVRPP-së përkatëse, në mënyrë që të bëhet e mundur ecja me ritme sa më të shpejta në procesin e regjistrimit të aseteve. Gjithashtu, me qëllim plotësimin e dokumentacionit, “Albgaz” sh.a. ka aplikuar për transferim të lejes mjedisore (tip A) nga “Albpetrol” tek “Albgaz”, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe është ndërkohë në pritje.

- “Albgaz” sh.a. bën me dije, gjithashtu, se po merr të gjitha masat e nevojshme për plotësimin e kërkesave të vendimit 187, datë 10.11.2017, pavarësisht ndryshimeve në drejtimin e shoqërisë, si dhe strukturave të ministrive nga të cilat ka varësi ky subjekt.

- ERE, me shkresën nr. 439 prot., datë 13.6.2018, i është drejtuar shoqërisë “Albgaz” sh.a., duke kërkuar depozitimin brenda datës 18.6.2018, të të gjithë dokumentacionit të munguar, në kuadër të përmbushjes së detyrimit që buron nga ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, të Bordit të ERE-s.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 495 prot., datë 6.7.2018, ka përcjellë kërkesën për ndryshimin e afatit 6-mujor, të vendosur në pikën 1 të vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, për plotësimin e dokumentacionit të munguar, deri në datën 20.12.2018, për arsyet e sipërcituara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, “Mbi licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, me përmbajtje: “1. Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda afatit 6-mujor në mbështetje të nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar ...” ndryshon dhe bëhet: “1. Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.12.2018, në mbështetje të nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar....”

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të përcjellë këtë vendim pranë “Albgaz” sh.a. dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

**VENDIM****Nr. 178, datë 20.8.2018****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
E BORDIT TË ERE-s NR. 188, DATË
10.11.2017, “Për LICENCIMIN E
SHOQËRISË “ALBGAZ” SHA NË
AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT
TË GAZIT NATYROR”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; i ndryshuar, nenit 3, pika 50; nenit 22, pika 2, gjerat “a” dhe “b”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; nenit 113, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; nenit 4, pika 1, gjerat “a” dhe “b”; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.8.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike për një ndryshim në vendimin nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 188, datë 10.11.2017, licencoi shoqërinë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror.

- Sa më sipër, shoqëria “Albgaz” sh.a. brenda një afati 6-mujor në mbështetje me nenin 24, pika 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, kishte detyrimin për të plotësuar të gjithë dokumentacionin e munguar si më poshtë:

- dokumentacioni që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar;

- lejet dhe autorizimet mjedisore;

- një certifikatë sigurimi nga shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri) që evidenton mbulimin e përgjegjësisë për dëmtimet për plagosje, sëmundje ose raste të vdekjes së personave ose për humbjen ose shkatërrimin e pronës të shkaktuara ose që kanë rezultuar prej aktiviteteve të aplikantit në kuadër të licencës së kërkuar në një nivel përgjegjësie jo më të vogël se 10 milionë USD;

- plan biznesi;

- volumet e projektuara ditore për t'u përpunuar sipas vlerësimeve të aplikantit;

- programin e punës për zbatimin e projektit dhe jeta e pritshme e projektit;

- programi i parashikuar i mirëmbajtjes së sistemit të shpërndarjes;

- sasia mesatare e gazit natyror që parashikohet për t'u shpërndarë gjatë një viti mbështetur në një program tipik mujor.

- Në vijim të sa më sipër, ERE, me shkresën nr. 521/10 prot., datë 23.11.2017, bëri me dije shoqërinë “Albgaz” sh.a. për vendimmarrjen e sipërcituar, mungesën e dokumentacionit dhe kushteve të vendosura në dispozitivin e vendimit për plotësimin e dokumentacionit të munguar brenda afateve të përcaktuara.

- Në përgjigje të korrespondencës së sipërcituar të ERE-s, shoqëria “Albgaz” sh.a. me shkresën nr. 38/1, datë 14.5.2018, ka informuar ERE mbi përditësimin e procedurave të dokumentacionit si më poshtë:

- pajisja me certifikatë pronësie (Sheq i Madh, Fier-Drizë, Fier Gjonçë, Lavdan);

- procedurat në vijimësi për certifikatat në Cërrik, Drenovë dhe Balldren.

- Sa më sipër, “Albgaz” sh.a. informon ERE-n se ka bërë kërkesë pranë ZVRPP-së përkatëse, në mënyrë që të bëhet e mundur ecja me ritme sa më të shpejta në procesin e regjistrimit të aseteve. Gjithashtu, me qëllim plotësimin e dokumentacionit, “Albgaz” sh.a. ka aplikuar për transferim të lejes mjedisore (tip A) nga Albpetrol tek “Albgaz” sh.a., pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe është ndërkohë në pritje.

- “Albgaz” sh.a. bën me dije, gjithashtu, se po merr të gjitha masat e nevojshme për plotësimin e kërkesave të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, pavarësisht ndryshimeve në drejtimin e shoqërisë, si dhe strukturave të ministrive nga të cilat ka varësi ky subjekt.

- ERE, me shkresën nr. 439 prot., datë 13.6.2018, i është drejtuar shoqërisë “Albgaz” sh.a., duke kërkuar depozitim brenda datës 18.6.2018, të gjithë dokumentacionit të munguar, në kuadër të përmbushjes së detyrimit që buron nga ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe vendimi i Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017 të Bordit të ERE-s.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 495 prot., datë 6.7.2018, ka përcjellë kërkesën për ndryshimin e afatit 6-mujor, të vendosur në pikën 1, të vendimit



të Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, për plotësimin e dokumentacionit të munguar, deri në datën 20.12.2018, për arsyet që sipërcituara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, “Mbi licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, me përmbajtje: “1. Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda afatit 6-mujor në mbështetje të nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar ...”, ndryshon dhe bëhet: “1. Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.12.2018, në mbështetje të nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar...”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të përcjellë këtë vendim pranë “Albgaz” sh.a. dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 179, datë 20.8.2018

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 97, DATË 23.4.2018, “MBI MIRATIMIN E TARIFËS SË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA “ALBGZ” SHA, PËR VITIN 2018”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit, 13, pika 2 dhe nenit 17, pika “e”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe nenit 3, germa “g” dhe nenit 24, pika 4, të “Rregullores për organizimin funksionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.8.2018, mbasi shqyrtoi

relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi një shtesë në vendimin nr. 97, datë 23.4.2018, “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., për vitin 2018”, të Bordit të ERE-s, konstatoi se:

- Me shkresën nr. 797, datë 20.7.2018, Shoqëria “Albgaz” sh.a. i është drejtuar ERE-s me kërkesën për shpjegime referuar vendimit të Bordit të ERE-s nr. 97, datë 23.4.2018, “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a. për vitin 2018”.

- Albgaz kërkon interpretimin e pikës 1 të vendimit të sipërcituar, në lidhje me afatin kur duhet të fillojë aplikimi i tarifës së re, për lëshimin e faturave tatimore sipas pikës 1 të këtij vendimi, referuar përcaktimeve në vendimin nr. 14, të Bordit të ERE-s, datë 10.1.2018, “Mbi shtyrjen e afatit të tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 90, datë 7.6.2017, si dhe kontratës së transmetimit të gazit natyror të lidhur mes “Albpetrol” sh.a. dhe “Albgaz” sh.a”.

- Tarifa e përkohshme e transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., e miratuar për vitin 2017 dhe lënë në fuqi deri më 31.3.2018 nëpërmjet vendimit nr. 14, datë 10.1.2018, të Bordit të ERE-s përcakton një tarifë prej 25 lekë/m³.

- Tarifa e transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., për vitin 2018 e miratuar me vendimin nr. 97, datë 23.4.2018, përcakton një tarifë prej 28 lekë/m³.

- Neni 17, germa “e”, e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, parashikon që kur tarifat e miratuara rezultojnë të ndryshme nga ato të përkohshme, ERE vendos masat e përshtatshme kompensuese.

- Mes tarifës së përkohshme të transmetimit dhe tarifës përfundimtare të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., për vitin 2018 rezulton një diferencë prej 3 lekë/m³.

- Neni 24, pika 4 e “Rregullores për organizimin funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, parashikon se, në çdo rast të paraqitjes së kërkesave për shprehje mendimi nga ana e ERE-s për interpretime të akteve nënligjore të ERE-s, ky mendim do të jetë rezultat i diskutimit dhe qëndrimit të mbajtur në mbledhjen e Bordit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 97, datë 23.4.2018 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., për vitin 2018”, të Bordit të ERE-s ishte “Miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., për vitin 2018 prej 28 lekë/m³ ose 2.6457 lekë/kwh” dhe bëhet “Miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., për vitin 2018 prej 28 lekë/m³ ose 2.6457 lekë/kwh, duke filluar nga data 1.1.2018”.

2. Shoqëria të bëjë korrigjimin e faturave për periudhën 1.1.2018–30.3.2018.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 180, datë 20.8.2018

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ALESIO–2014” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“FUSHË-ARRËZ”, ME FUQI
TË INSTALUAR 1990 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 15, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.8.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi licencimin e shoqërisë “Alesio–2014” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 143, datë 25.6.2018, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Alesio–2014” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Fushë-Arrëz”, me fuqi të instaluar 1990 kw.

- ERE, me shkresën nr. 55/38 prot., datë 26.6.2018, ka bërë njoftimin në media për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit.

- ERE, me shkresën nr. 420/1 prot., datë 28.6.2018, i ka kërkuar subjektit plotësimin e dokumentacionit të munguar ose jo të plotë, që konsistonte në:

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2, germa “d” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” (rifreskimi i vërtetimit nga Prokuroria dhe Gjykata);

- dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3, germa “a”, të Rregullores sipërcituar (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave). Neni 9, pika 3, germa “c”, të Rregullores sipërcituar (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit);

- dokumentacioni teknik për HEC-in. Neni 9, pika 4.1.3, germa “b” të Rregullores sipërcituar (një diagram elektrik në format A1 të agregateve dhe bllokut të transformimit ku të evidentohen qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes).

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 420/3 prot., datë 7.8.2018, subjekti “Alesio 2014”, ka përcjellë në ERE të gjithë dokumentacionin e kërkuar.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezulton të ketë vërejtje apo ankesë nga palë të treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Alesio–2014” sh.p.k.

- Në përfundim të shqyrtimit, rezulton se aplikimi i shoqërisë “Alesio–2014” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Kontrata nr. 986 rep. dhe nr. 431/2 kol., datë 9.5.2018, e lidhur ndërmjet shoqërisë “Alesio–



2014” sh.p.k., në cilësinë e mbajtësit të miratimit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë parashikon një kohëzgjatje prej 49 vjetësh. Neni 38, pika 1, germa “a”, i ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikon se afati i vlefshmërisë së licencës për veprimtarinë e prodhimit, nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet. Neni 5, pika 1, germa “a” i “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, parashikon se kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencës për prodhimin e energjisë elektrike është deri në 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Alesio–2014” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Fushë-Arrëz”, me fuqi të instaluar 1990 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 181, datë 20.8.2018

MBI MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE TË SHOQËRISË OSHEE SHA, PËR VITIN 2018

Në mbështetje të neneve 16; 20, germa “a” dhe “e” dhe nenit 75, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 9 dhe 10, neneve 11, 12, 13 të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 135, datë 6.9.2017; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.8.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës së ERE-s, në lidhje me miratimin e Planit të Investimeve të shoqërisë OSHEE sh.a., për vitin 2018,

Faqe | 9406

konstatoi se:

- Me shkresën me nr. 808 prot., datë 15.1.2018, OSHEE sh.a. ka paraqitur pranë ERE-s “Planin e Përditësuar të Investimeve” për vitin 2018.

- Grupi i punës së ERE-s, i ngritur me urdhrin nr. 14, datë 1.2.201, të kryetarit të ERE-s, shqyrtoi aplikimin e dërguar nga shoqëria OSHEE sh.a.

- Me vendimin nr. 47, datë 7.3.2018, ERE vendosi: Fillimin e procedurës për miratimin e planit të investimeve të shoqërisë OSHEE sh.a., për vitin 2018.

- Në datën 24.4.2018, ERE organizoi seancën dëgjimore me përfaqësues të OSHEE sh.a., lidhur me mangësitë e konstatuara në planin e investimeve.

- Në shkresën me nr. 6942/1, datë 24.4.2018, shoqëria OSHEE sh.a., dërgoi planin e përditësuar të investimeve për vitin 2018 dhe planin e përditësuar 5-vjeçar (2018–2020).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Investimeve të shoqërisë OSHEE sh.a., për vitin 2018, bashkëlidhur tabelës.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti



Nr.	Emërtimi i investimit	TOTALI 2018	Burimi i financimit		Qëllimi i realizimit të investimit				
			Kap. vetjak (lekë)	Banka Botërore Hua (lekë)	Rritje e sigurisë	Qendr. në furnizim	Reduktim humbjeje tek.	Reduktim humbjeje jo tek.	Rritje arkëtimi
I	Ndërtim/rikonstruksion elektrik për nënstacionet	839,204,488	128,528,375	710,676,113					
1	Fuqizim i Nënstacionit të Traktorëve 110/35/20/6	128,528,375	128,528,375		x	x	x		
2	Furnizim dhe instalim në nënstacion (Tirana Kombinat)	255,114,495	-	255,114,495					
3	Furnizim dhe instalim në nënstacion (Tirana Qendër 1)	455,561,618	-	455,561,618					
II	Ndërtim/rikonstruksion linjash të TL	450,000,000	450,000,000						
1	Rikonstruksion i rrjetit kabllor 35 kV i furnizimit N/stacionit të Kongreseve	140,000,000	140,000,000		x	x	x		
2	Furnizimi i ri me 110/20 kV i Velipojës dhe ndërtimi i Pikës Shpërndarëse 110/20 kV	310,000,000	310,000,000		x	x	x		
III	Blerje pajisje makinerie për N/Stacione dhe likuidim avarish	2,040,567,776	1,320,000,000	720,567,776					
1	Makineri-pajisje për lokalizimin dhe përcaktimin e defekteve në rrjetin shpërndarës	200,000,000	200,000,000		x	x			
2	Salla baterish për N/stacione	170,000,000	170,000,000		x	x			
3	Një transformuese për N/stacione	200,000,000	200,000,000		x	x			
4	Rikonstruksion i nyjave kritike për TL-në	200,000,000	200,000,000		x	x			
5	Pajisje për nyjat kritike në qarqet sekondare	200,000,000	200,000,000		x	x			
6	Pajisje komutuese të tensionit të mesëm	200,000,000	200,000,000		x	x			
7	Një transformuese në TM	150,000,000	150,000,000		x	x			
8	Shtylla betoni për linjat TU (10,000 copë)	64,602,776		64,602,776					
9	Blerje kabllorje të tensionit të mesëm dhe tensionit të ulët	655,965,000		655,965,000					
IV	Ndërtim rrjeti TM	87,991,908	87,991,908						
1	Inspektimi dhe konformiteti për pajisjet dhe instalimet elektrike. Mbikëqyrja e fushës elektromagnetike në n/stacione dhe kabina elektrike.	87,991,908	87,991,908		x				
V	Ndërtim/rikonstruksion rrjeti TM /TU	1,798,240,973	1,798,240,973						
1	Ndërtimi i fiderit 356 ,20 kV, n/stacioni rajonal	139,411,537	139,411,537		x	x	x	x	x
2	Projektim - zbatim i monitorimit të plotë të tunelit të kabllorëve në n/st. qendër	50,000,000	50,000,000		x	x	x	x	x
3	Studimi, analiza e furnizimit të pandërprerë me energji elektrike dhe rritja e shkallës së sigurisë së rrjetit të Tiranës	65,000,000	65,000,000		x	x			
4	Studimi i zhvillimit të rrjetit inxhinierik për furnizimin me energji elektrike në qendër të Tiranës në përputhje me zhvillimin urban të Bashkisë, Tiranë	55,000,000	55,000,000		x	x			
5	Rikonfigurimi i rrjetit 20 kV i zonës së Zogut të Zi , n/stacioni qendër dhe rajonal	130,000,000	130,000,000		x	x	x	x	x



6	Miratim investimi “Linja TM 20 kV Fideri E 10, kabina tip boks, daljet e para TU dhe vendosje cele në n/stacionin Farkë”	88,363,000	88,363,000		x	x	x	x	x
7	Miratim investimi “Kabina tip boks ‘K1’ (Baldushk/E5 e n/stacionit Farkë dhe linja TU me kablo ABC”	12,311,550	12,311,550		x	x	x	x	x
8	Miratim investimi “Lidhja unazore e fiderave 20 kV F7 dhe F8 të n/stacionit Kashar”	3,354,359	3,354,359		x	x			
9	Miratim investimi “Lidhja unazore e fiderave 20 kV A7 dhe F355 të n/stacionit rajonal kab ‘Konservimi Gjakut”	434,727	434,727		x	x			
10	Spostimi i kabinës boks “Shkolla Kosova”	2,316,493	2,316,493		x	x	x	x	x
11	Spostimi i kabinës “Amfiteatri”	2,157,524	2,157,524		x	x	x	x	x
12	Spostimi i kabinës boks “Mihal Duri”	6,441,392	6,441,392		x	x	x	x	x
13	Miratim investimi “Lidhja unazore e fiderave 20 kV F5 të n/st. Salmone dhe F-8 n/st. Kashar”	15,009,694	15,009,694		x	x			
14	Kalimi nga 6 në 20 kV i kabinës Ambasada e Kosovës (Ish-OSBE)	4,554,483	4,554,483		x	x			
15	Ndërtim linje TM, 6 kV, kabina shtyllore 100 kVA, shkolla Paskuqan dhe linja TU me kablo ABC	3,650,000	3,650,000		x	x	x	x	x
16	Kthim nga 6 kV në 20 kV i kabinës elektrike ekzistuese “Poligrafiku”	2,710,000	2,710,000		x	x	x		
17	Ndërtim rrjeti TM, kabinë elektrike shtyllore Rade 4, si dhe rrjeti TU, Fideri F4, n/stacioni Manzhë	6,000,000	6,000,000		x	x	x	x	x
18	Zhvillimi i rrjetit 20 kV TM /TU në qytetin e Fushë-Krujës	133,519,099	133,519,099		x	x	x	x	x
19	Ndërtim rrjeti TM, 20 kV, si dhe kabinave dhe rrjet TU me ABC në zonën Shelq, Fier, n/stacioni Fier	42,730,547	42,730,547		x	x	x	x	x
20	Projektit të rikualifikimit të zonës urbane pranë qendrës së qytetit të Vlorës	27,000,000	27,000,000		x	x	x	x	x
21	Miratim investimi “Ndërtimi i rrjetit 20 TM/TU kV, si dhe kabinë e re BOX URA E KIRIT, F-10, n/st. SH2 Shkodër”	8,263,946	8,263,946		x	x	x	x	x
22	Ndërtim rrjeti TM me kablo 20 kV, XLPE 3x (1x185) mm ² për furnizimin e kabinës Dogana Hani i Hotit, Malësi e Madhe	2,670,000	2,670,000		x	x			
23	Ndërtim i LTM-së “Spitali Rajonal”, Shkodër	6,215,921	6,215,921		x	x	x	x	
24	Rikonstruksion i rrjetit TM /TU, zona Theth	34,267,351	34,267,351		x	x	x	x	x
25	Miratim investimi “Rikonstruksioni i Fiderit Buzëmadh 10 kV, n/stacioni 35/10/6 kV Cakran, si dhe rikonstruksioni i kabinave 10/0.4 kV dhe linjave TU të tyre”	29,479,385	29,479,385		x	x	x	x	x
26	Miratim investimi “Kabina e re shtyllore Kafaraj 3, Fideri nr. 26, 6 kV, n/stacioni Kafaraj 110/35/6 kV”	2,619,739	2,619,739		x	x	x	x	x
27	Miratim investimi “Ndërtimi i dy segmenteve TM që do të furnizojnë fiderat 1 dhe 2 nga n/stacioni i ri Qar 35/6 kV”	5,900,000	5,900,000		x	x	x		
28	Rikonstruksion kabinave TM dhe ndërtim rrjeti TU me kablo ABC, njësia Lushnjë	101,100,000	101,100,000		x	x	x	x	x
29	Miratim investimi “Ndërtim i rrjetit TM, TU dhe kabina shtyllore në agjencinë Burrel me punonjësit e OSHEE-së”	11,341,194	11,341,194		x	x	x	x	x
30	Rikonstruksioni i fiderit të Ujësjellësit, n/stacioni Bajram Curri (Valbonë)	200,000,000	200,000,000		x	x	x	x	x



31	Ndërtimi i rrjetit të ri elektrik në autostradën Laç, Mamurras	236,095,509	236,095,509		x	x	x	x	x
32	Rikonstruksion rrjeti TM ajror, fideri nr. 3, n/st. Kurbnesh 110/6 kV	11,000,000	11,000,000		x	x	x		
33	Rikonstruksion rrjeti TM ajror, fideri hekurudha n/st. LAC. 1 110/6 kV	12,043,599	12,043,599		x	x	x		
34	Rikonstruksion rrjeti TM ajror, fideri nr. 5 n/st. REPS 110/6 kV	28,928,262	28,928,262		x	x	x		
35	Zhvillimi i rrjetit shpërndarës 20 kV TM/TU në agjencinë e Elbasanit	318,351,662	318,351,662		x	x	x	x	x
VI	Ndërtim/rikonstruksion kabinash elektrike	918,662,433	500,000,000	418,662,433					
1	Rikonstruksion rrjeti TM 20 kV (8 lote)	150,000,000	150,000,000		x	x	x	x	
2	Rikonstruksion i kabinave elektrike (ndërtimor dhe elektrik)	250,000,000	250,000,000		x	x	x	x	
3	Ndërtimi i zyrave të rajonit Durrës	100,000,000	100,000,000						
4	Blerje transformatorësh	418,662,433	-	418,662,433					
VII	INVESTIMET PRIORITARE (RRJET TU - ABC LINES)	1,059,205,517	1,059,205,517	-					
1	Ndërtim i fiderit të ri n/st. Mifol për zonën Novoselë–Akerni–Bishan, si dhe rrjet TU me ABC	66,302,329	66,302,329		x	x	x	x	x
2	Rikonstruksion rrjeti TU me kablo ABC në zonën e Peqinit (lista analitike mars 2017)	89,592,613	89,592,613		x	x	x	x	x
3	Miratim investimi “Rikonstruksion rrjeti TU me kablo ABC në kabinën Bulkar Sipër”	2,900,208	2,900,208		x	x	x	x	x
4	Ndërtim linje TU me kablo me vetëmbajtje ABC të kabinave “B5”, “B6”, “B7”, “B8”, “B9” të fiderit F-17, n/st. Kashar Tiranë	11,250,000	11,250,000		x	x	x	x	x
5	Ndërtim linje TU me kablo me vetëmbajtje ABC të disa segmenteve të kabinave K-4, K-6, K-7, të fiderit A20 të n/stacionit Rajonal Tiranë	830,000	830,000		x	x	x	x	x
6	Ndërtim rrjeti TU 0.4 kV në rajonin Tiranë	350,000,000	350,000,000		x	x	x	x	x
7	Ndërtim rrjeti TU 0.4 kV (lista analitike mars 2017)	138,330,367	138,330,367		x	x	x	x	x
8	Ndërtim rrjeti TU 0.4 kV në rajonin Shkodër	240,000,000	240,000,000		x	x	x	x	x
9	Ndërtim rrjeti TU 0.4 kV në rajonin Lezhë	160,000,000	160,000,000		x	x	x	x	x
VIII	Teknologji monitorimi	570,914,990	376,936,514	193,978,476					
1	Instalimi, montimi i sistemit të kontrollit të rrjetit të Vlorës (faza e parë)	26,936,514	26,936,514						
2	Investimi për sistemin SCADA	200,000,000	200,000,000						
3	Automatizimi i komandimit në distancë (RTU)	150,000,000	150,000,000						
4	Investime të sistemin <i>Billing</i>	193,978,476	-	193,978,476					
IX	Investime në matje	1,380,000,000	1,380,000,000						
1	Investimi në matjen e bilancit në tensionin e ulët të kabinave dhe MDM (n/stacioni Shkodra 1)	980,000,000	980,000,000					x	
2	Matës bilanci në kabinë	200,000,000	200,000,000						
3	Blerje matësish për konsum të energjisë + materiale ndihmëse	200,000,000	200,000,000						
X	Vlera 10% që do të paguhet nga OSHEE-ja për investimet e Bankës Botërore	179,201,439	179,201,439						
1	Vlera për investimet në rrjet	103,022,215	103,022,215						
2	Vlera për investimet e komponentit të dytë	76,179,224	76,179,224						



XI	Kostoja lokale për investimet e Bankës Botërore	1,347,314,549	1,347,314,549						
1	Vlera për investimet në rrjet	647,314,549	647,314,549						
2	Vlera për investimet e komponentit të dytë	700,000,000	700,000,000						
2.1	Blerje ura lidhëse kabllore TR-Panel TU, materiale, aksesore nga OSHEE-ja për 16659 kabina elektrike		212,318,338						
2.2	Instalimi i zërave më sipër + punime civile për rikonstruksionin e kabinave		254,888,593						
2.3	Rikonstruksioni i n/stacionit Jagodinë (faza e parë)		36,000,000						
2.4	Rrjet TU me përcjellës ABC në Tiranë		196,793,069						
XII	Oponencë, supervizion, kolaudim		10,000,000						
XIII	Projektime n/stacionesh		80,000,000						
XIV	Vlere e parashikuar për shpronësim		10,000,000						
XV	Studime me të tretë për marrjen e lejeve të ndërtimit (topografik, gjeologjik, arkeologjik, mjedisor)		10,000,000						
XVI	Programe inxhinierike		20,000,000						
	TOTALI	10,671,304,072	8,757,419,274	2,043,884,798					

**VENDIM****Nr. 182, datë 20.8.2018****MBI MIRATIMIN E PLANIT TË
ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE, PËR PERIUDHËN
5-VJEÇARE (2018–2022)**

Në mbështetje të neneve 16, 20, germat “a” dhe “e” dhe nenit 75, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 9 dhe 10, nenet 11, 12, 13, të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 135, datë 6.9.2017, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.8.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës së ERE-s, në lidhje me miratimin e Planit të Zhvillimit të Rrjetit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, për periudhën 5-vjeçare (2018–2022),

konstatoi se:

- Me shkresën me nr. 808 prot., datë 15.1.2018, OSHEE sh.a. ka paraqitur pranë ERE-s “Planin e përditësuar të investimeve për periudhën 5-vjeçare (2018–2022)”.

- Grupi i punës, i ngritur me urdhrin nr. 14, datë 1.2.2018, të Kryetarit të ERE-s, shqyrtoi aplikimin e dërguar nga shoqëria OSHEE sh.a.

- Me vendimin nr. 48, datë 7.3.2018, ERE vendosi: Fillimin e procedurës për miratimin e planit të zhvillimit të Rrjetit të Shpërndarjes së energjisë elektrike, për periudhën 5-vjeçare (2018–2022).

- Në datën 24.4.2018, ERE organizoi seancën dëgjimore me përfaqësues të OSHEE sh.a., lidhur me mangësitë e konstatuara në planin e investimeve.

- Me shkresën me nr. 6942/1, datë 24.4.2018, shoqëria OSHEE sh.a., dërgoi planin e përditësuar të investimeve për vitin 2018 dhe planin e përditësuar 5-vjeçar (2018–2022).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë planin e zhvillimit të Rrjetit të Shpërndarjes së energjisë elektrike, për periudhën 5-vjeçare (2018–2022), sipas tabelës bashkë-lidhur.

2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, kur aplikon për tarifa, të paraqesë pranë ERE-s “Planin e përditësuar të investimeve”, që i korrespondon periudhës përkatëse rregullatore.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë OSSH-në për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti



PLANI I ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË SHPËRNDARJES PERIUDHA 2018–2022 (ME FONDET E OSHEE-së) (LEKË)						
Nr.	Emërtimi i investimit	Totali 2018	Totali 2019	Totali 2020	Totali 2021	Totali 2022
I	Ndërtim/rikonstruksion elektrik për nënstacionet	128,528,375	947,500,000	1,317,500,000	700,000,000	250,000,000
1	Fuqizim i n/stacionit të Traktorëve 110/35/20/6	128,528,375				
2	N/stacioni 110/10 kV Leskovik		200,000,000			
3	N/st. 110/35/10, Lozhan, Korçë			400,000,000		
4	Ndërtimi i n/st. të ri në SHËNGJIN 110/20 kV			600,000,000		
5	N/st. 110/35 Bulqizë 2				450,000,000	
6	Rikonstruksion i n/stacionit të Bunecit 35/20/10 kV 2x3.15 MVA		140,000,000			
7	Ndërtim i n/stacionit të Livadhjasë 35/20 kV 2x3.15 MVA		140,000,000			
8	Ndërtim i n/stacionit të Tamarë 35/20/10 kV		250,000,000			
9	N/St Pogradec 110/20/35/10 kV			100,000,000	250,000,000	250,000,000
10	Furnizim me linjë të dytë 110 kV I n/stacionit Qendër		217,500,000	217,500,000		
II	Ndërtim/rikonstruksion linjash të TL	450,000,000	662,100,000	130,000,000	200,000,000	-
1	Rikonstruksion i rrjetit kabllor 35 kV i furnizimit n/stacionit të Kongreseve	140,000,000				
2	Furnizimi i ri me 110/20 kV i Velipojës dhe ndërtimi i pikës shpërndarëse 110/20 kV	310,000,000				
3	Rikonstruksion dhe ndërtim i LINJËS 35 kV, segmenti Bunec–Sarandë		60,000,000			
4	Rikonstruksion i linjës 35kV, n/stacioni Koplik-N/stacioni Vukpalaj		25,000,000			
5	Rikonstruksion linja 35 kV TEC-Ndroq L 30- 3/1		81,900,000			
6	Rikonstruksion linja 35 kV Pukë - Koman		74,200,000			
7	Rikonstruksion linja 35 Kv, L-30-50/1, L-30-50/2 (Shkodra 2 – Cas–Velipojë)		205,000,000			
8	Ndërtimi i linjës 35 kV Vukpalaj–Tamarë		90,000,000			
9	Rikonstruksion linja 35 kV degëzimi i Manzës L 30-33		46,200,000			
10	Linja TL për furnizimin e n/st. 110/35 Bulqizë 3			130,000,000	200,000,000	
11	Rikonstruksion Linja 35 kV HEC-Qafëmollë-Kinostudio L 30-15		79,800,000			
III	Ndërtim Rrjeti TM	87,991,908	-	-	-	-
1	Inspektimi dhe konformiteti për pajisjet dhe instalimet elektrike. Mbikëqyrja e fushës elektromagnetike në n/stacione dhe kabina elektrike.	87,991,908				
IV	Blerje pajisje makineri për n/stacione dhe likuidim avarish	1,320,000,000	-	-	-	-
1	Makineri - pajisje për lokalizimin dhe përcaktimin e defekteve në rrjetin shpërndarës	200,000,000				
2	Salla baterish për n/stacione	170,000,000				
3	Nyje transformuese për n/stacione	200,000,000				
4	Rikonstruksion i nyjave kritike për TL	200,000,000				
5	Pajisje për nyjat kritike në qarqet sekondare	200,000,000				
6	Pajisje komutuese të tensionit të mesëm	200,000,000				
7	Nyje transformuese në TM	150,000,000				
V	Ndërtim/rikonstruksion rrjeti TM /TU	1,798,240,973	1,711,392,502	3,061,007,398	4,381,777,329	303,539,347
1	Ndërtimi i fiderit 356, 20 kV, n/stacioni Rajonal	139,411,537				
2	Projektim - zbatim i monitorimit të plotë të tunelit të kabllorëve në n/st. Qendër	50,000,000				
3	Studimi, analiza e furnizimit të pandërprerë me energji elektrike dhe rritja e shkallës së sigurisë së rrjetit të Tiranës	65,000,000				
4	Studimi i zhvillimit të rrjetit inxhinierik për furnizimin me energji elektrike në qendër të Tiranës në përputhje me zhvillimin urban të Bashkisë Tiranë	55,000,000				
5	Rikonfigurimi i rrjetit 20 kV i zonës së Zogut të Zi, n/stacioni Qendër dhe Rajonal	130,000,000				
6	Miratim investimi “Linja TM 20 kV Fideri E 10, kabina tip boks, daljet e para TU dhe vendosje cele në n/stacionin Farkë”	88,363,000				
7	Miratim investimi “Kabina tip boks “K1” (Baldushk/E5 e n/stacionit Farkë dhe linja TU me kabllor ABC”	12,311,550				
8	Miratim investimi “Lidhja unazore e fiderave 20 kV F7 dhe F8 të n/stacionit Kashar”	3,354,359				
9	Miratim investimi “Lidhja unazore e fiderave 20 kV A7 dhe F355 të n/stacionit Rajonal kab. “Konservimi i Gjakut”	434,727				
10	Spostimi i kabinës boks “Shkolla Kosova”	2,316,493				
11	Spostimi i kabinës “Amfiteatri”	2,157,524				
12	Spostimi i kabinës boks “Mihal Duri”	6,441,392				
13	Miratim investimi “Lidhja unazore e fiderave 20 kV F5 të n/st. Salmone dhe F-8 n/st. Kashar”	15,009,694				



14	Kalimi nga 6 në 20 kV i kabinës Ambasada e Kosovës (ish-OSBE-ja)	4,554,483				
15	Ndërtim linje TM, 6 kV, kabina shtyllore 100 kVA, shkolla Paskuqan dhe linja TU me kablo ABC	3,650,000				
16	Kthim nga 6kV në 20 kV i kabinës elektrike ekzistuese “Poligrafiku”	2,710,000				
17	Ndërtim rrjeti TM, kabinë elektrike shtyllore Radë 4, si dhe rrjeti TU, Fideri F4, n/stacioni Manzë	6,000,000				
18	Zhvillimi i rrjetit 20 kV TM/TU në qytetin e Fushë-Krujës	133,519,099				
19	Ndërtim rrjeti TM, 20 kV, si dhe kabinave dhe rrjet TU me ABC në zonën Shelq, Fier, n/stacioni Fier	42,730,547				
20	Projektit të rikualifikimit të zonës urbane pranë qendrës së qytetit të Vlorës	27,000,000				
21	Miratim investimi “Ndërtimi i rrjetit 20 TM/TU kV, si dhe kabinë e re BOX URA E KIRIT, F-10, n/st. SH2 Shkodër”	8,263,946				
22	Ndërtim rrjeti TM me kablo 20 kV, XLPE 3x(1x185) mm ² për furnizimin e kabinës Dogana Hani i Hotit, Malësi e Madhe	2,670,000				
23	Ndërtim i LTM “Spitali Rajonal”, Shkodër	6,215,921				
24	Rikonstruksion i rrjetit TM /TU Zona Theth	34,267,351				
25	Miratim investimi “Rikonstruksioni i Fiderit Buzëmadh 10 kV, n/stacioni 35/10/6 kV Cakran, si dhe rikonstruksioni i kabinave 10/0.4 kV dhe linjave TU të tyre”	29,479,385				
26	Miratim investimi “Kabina e re shtyllore Kafaraj 3, Fideri nr. 26, 6 kV, n/stacioni Kafaraj 110/35/6 kV”	2,619,739				
27	Miratim investimi “Ndërtimi i dy segmenteve TM që do të furnizojnë Fiderat 1 dhe 2 nga n/stacioni i ri Qar 35/6 kV”	5,900,000				
28	Rikonstruksion i kabinave TM dhe ndërtim rrjeti TU me kablo AB, njësia Lushnjë	101,100,000				
29	Miratim investimi “Ndërtim i rrjetit TM, TU dhe kabina shtyllore në Agjencinë Burrel me punonjësit e OSHEE-së”	11,341,194				
30	Rikonstruksion i Fiderit të Ujësjellësit, n/stacioni Barjam Curri (Valbonë)	200,000,000				
31	Ndërtimi i rrjetit të ri elektrik në autostradën Laç–Mamurras	236,095,509				
32	Rikonstruksion rrjeti TM ajror, Fideri NR. 3 n/st. KURBNESH 110/6 kV	11,000,000				
33	Rikonstruksion rrjeti TM ajror, Fideri HEKURUDHA n/st. LAC.1 110/6 kV	12,043,599				
34	Rikonstruksion rrjeti TM ajror, Fideri NR. 5 N/ST REPS 110/6 kV	28,928,262				
35	Zhvillimi i Rrjeti shpërndarës 20 kV TM/TU në Agjencinë e Elbasanit	318,351,662				
36	Zhvillimi i rrjetit TM/TU në Delvinë	30,000,000				
37	Zhvillimi i rrjetit TM/TU në Glinë	30,000,000				
38	Ndërtimi fideri 1 20 kV i Ri, kabina, rrjeti TU				67,379,651	
39	Ndërtimi fideri 2 20 kV i Ri, kabina, rrjeti TU				48,460,287	
40	Ndërtimi fideri 3 20 kV i Ri, kabina, rrjeti TU				122,440,724	
41	Ndërtimi fideri 4 20 kV i Ri, kabina, rrjeti TU				87,556,833	
42	Ndërtimi fideri 5 20 kV i Ri, kabina, rrjeti TU				64,252,059	
43	Ndërtimi fideri 6 20 kV i Ri, kabina, rrjeti TU				70,570,749	
44	Ndërtimi fideri 7 20 kV i Ri, kabina, rrjeti TU				85,662,858	
45	Ndërtimi i kolektorit dalës të fiderave 20 kV				7,650,634	
46	Linja ajrore TM Tushemisht				9,650,003	
47	Tri linja TM 20 kV për mbylljen e unazave				7,465,122	
48	Ndërtimi i rrjetit TM 20 kV te ndërtimi i kabinave të reja dhe rikonstruksioni i kabinave ekzistuese të N/stacionit të ri Lozhan 110/35/10 kV			303,539,347	303,539,347	303,539,347
49	Ndërtimi i rrjetit TM 20 kV te ndërtimi i kabinave të reja dhe rikonstruksioni i kabinave ekzistuese të n/stacionit të ri Leskovik 110/10 kV				1,341,481,765	
50	“Ndërtim rrjeti TU me kablo ABC, kabinat e fideri nr. 7(10 kV), n. stacioni Kuçovë”	76,000,000				
51	“Ndërtimi i rrjetit TU me kablo ABC fideri nr. 8 (10 kV) n. stacioni Kuçovë”	61,122,048				
52	Investime rrjet TM/TU, loti I Berat (lista analitike mars 2017)	24,225,104				
53	Investime rrjet TM/TU, loti II Berat (lista analitike mars 2017)	34,404,755				



54	Investime rrjet TM/TU, loti III Berat (lista analitike mars 2017)		35,009,728			
55	Investime rrjet TM/TU, loti II Lushnjë (lista analitike mars 2017)		109,093,471			
56	Ndërtim i Fiderit A5 20 kV Berat dhe kabinave dhe rrjetit TU me kablo ABC		67,633,255			
57	Fideri i ri 20 kV Nr. 9 (kthimi Fiderit Nr2/6kV N/St Plastmasë në 20 kV)			286,347,778		
58	Ndërtim rrjeti TM 20 kV, ndërtim kabinash elektrike, si dhe rrjet TU me përcjellës ABC, Tamarë		95,000,000	95,000,000		
59	Zhvillimi i rrjetit 20 kV TM/TU në Zejmen, Lezhë		120,000,000			
60	Ndërtim i rrjetit TM/TU në zonën Trush (linjë TM, Kabina elektrike dhe rrjet TU me përcjellës ABC)		60,000,000			
61	Ndërtim i rrjetit TM 20 kV te ndërtimi i kabinave të reja dhe rikonstruksioni i kabinave ekzistuese të n/stacionit të ri Velipojë 110/20 kV		150,000,000	265,596,928	381,193,857	
62	Ndërtim i rrjetit TM 20 kV te ndërtimi i kabinave të reja dhe rikonstruksioni i kabinave ekzistuese të n/stacionit të ri Shëngjin 110/20 kV			569,136,275	569,136,275	
63	Ndërtim i rrjetit TM 20 kV te ndërtimi i kabinave të reja dhe rikonstruksioni i kabinave ekzistuese të n/stacionit të ri VALIAS 110/20 kV			910,618,040	910,618,040	
64	Ndërtim i rrjetit TM 20 kV te ndërtimi i kabinave të reja dhe rikonstruksioni i kabinave ekzistuese të n/stacionit Zugu i Zi 110/20 kV		226,049,902	326,049,902		
65	Ndërtim i rrjetit TM 20 kV te ndërtimi i kabinave të reja dhe rikonstruksioni i kabinave ekzistuese të n/stacionit të ri Gjiri i Lalëzit 110/20 kV		304,719,129	304,719,129	304,719,128.78	
66	“Fideri i ri C19 nga n/st. Traktora për kabinat që furnizon Fideri 85, si dhe rrjeti TU me ABC i këtyre kabinave”,		188,135,110			
67	Rikonstruksioni i rrjetit kabllor 6 kV në nivelin 20 kV për objektet qeveritare		100,000,000			
VI	Ndërtim/rikonstruksion kabinash elektrike	500,000,000	1,380,322,930	-	-	-
1	Rikonstruksion rrjeti TM 20 kV (8 lote)	150,000,000	650,000,000			
2	Rikonstruksion i kabinave elektrike (ndërtimor dhe elektrik)	250,000,000	550,000,000			
3	Ndërtimi i zyrave të rajonit Durrës	100,000,000	115,000,000			
4	“Rikonstruksioni i zyrave Agjencia Pogradec”		12,611,941			
5	Projekt, preventiv, relacion teknik: “Godinë multifunksionale OSHEE, njësia Ballsh”		52,710,989			
VII	Investimet prioritare (Rrjet TU - ABC lines)	1,059,205,517	1,374,232,582	2,731,039,994	1,646,217,388	-
1	Ndërtim i fiderit të ri N/ST. MIFOL për zonën Novoselë-Akerni-Bish.an, si dhe rrjet TU me ABC	66,302,329				
2	Rikonstruksion Rrjeti TU me kablo ABC në zonën e Peqinit (lista analitike mars 2017)	89,592,613				
3	Miratim investimi “Rikonstruksion rrjeti TU me kablo ABC në kabinën Bulkar Siper”	2,900,208				
4	Ndërtim linje TU me kablo me vetëmbajtje ABC të kabinave “B5”, “B6”, “B7”, “B8”, “B9” të fiderit F-17, n/st. Kashar Tiranë	11,250,000				
5	Ndërtim linje TU me kablo me vetëmbajtje ABC të disa segmenteve të kabinave K-4, K-6, K-7, të fiderit A20 të n/stacionit Rajonal Tiranë	830,000				
6	Ndërtim Rrjet TU 0.4 kV në Rajonin Tiranë	350,000,000				
7	Ndërtim Rrjet TU 0.4 kV (lista analitike mars 2017)	138,330,367				
8	Ndërtim Rrjet TU 0.4 kV në Rajonin Shkodër	240,000,000				
9	Ndërtim Rrjet TU 0.4 kV në Rajonin Lezhë	160,000,000				
10	KALIMI I NJOLLAVE TË RRJETIT 6 kV NË RRJETIN 20 kV, QYTETI VLORË		100,072,912			
11	Ndërtimi i rrjetit TU, ABC të n/stacionit të ri VALIAS 110/20 kV		356,122,897	356,122,897	356,122,897	
12	Ndërtimi i rrjetit TU, ABC të n/stacionit Zogu i Zi 110/20 kV		304,751,738	304,751,738		
13	Ndërtimi i rrjetit TU, ABC të n/stacionit Kinostudio 110/20kV		205,910,144	205,910,144	205,910,144	
14	Ndërtimi i rrjetit TU, ABC të n/stacionit të ri Lozhan 110/35/10 kV			734,184,346		
15	Ndërtimi i rrjetit TU, ABC të n/stacionit të ri Leskovik 110/10 kV				275,319,130	
16	Ndërtimi i rrjetit TU, ABC të n/stacionit të ri Shëngjin 110/20 kV			458,865,217	458,865,217	
17	Ndërtimi i rrjetit TU, ABC të n/stacionit të ri Velipojë 110/20 kV		321,205,652	321,205,652		



18	Ndërtimi i rrjetit TU ,ABC të n/stacionit të ri Gjiri i Lalëzit 110/20 kV			350,000,000	350,000,000	
19	Ndërtim rrjeti TM/TU, LOTI II (lista analitike mars 2017)		32,497,849			
20	Ndërtim rrjeti TM/TU, LOTI IV (lista analitike mars 2017)		53,671,391			
VIII	Teknologji monitorimi	376,936,514	-	-	-	-
1	Instalimi, montimi i sistemit të kontrollit të rrjetit të Vlorës (faza e parë)	26,936,514				
2	Investimi për sistemin SCADA	200,000,000				
3	Automatizimi i komandimit në distancë (RTU)	150,000,000				
IX	Investime në matje	1,380,000,000	400,000,000	300,000,000	-	-
1	Matës bilanci në kabinë	200,000,000	400,000,000	300,000,000		
2	Investimi në matjen e bilancit në tensionin e ulët të kabinave dhe MDM (n/stacioni Shkodra 1)	980,000,000				
3	Blerje matës për konsum të energjisë + materiale ndihmëse	200,000,000				
X	Vlera 10% që do të paguhet nga OSHEE-ja për investimet Bankës Botërore	179,201,439	179,201,439	179,201,439	76,179,224	913,783,540
1	Vlera për investimet në rrjet	103,022,215	103,022,215	103,022,215		609,066,644
2	Vlera për investimet e komponentit të dytë	76,179,224	76,179,224	76,179,224	76,179,224	304,716,896
XI	Kostoja lokale për investimet e Bankës Botërore	1,347,314,549	1,063,899,163	714,381,998	467,206,931	3,239,644,786
1	Vlera për investimet në rrjet	647,314,549	596,692,232	247,175,067		2,072,437,855
2	Vlera për investimet e komponentit të dytë (analitikisht)	700,000,000	467,206,931	467,206,931	467,206,931	1,167,206,931
2.1	Blerje ura lidhëse kablore TR-Panel TU, materiale, aksesore nga OSHEE-ja për 16659 kabina elektrike	212,318,338	212,318,338	212,318,338	212,318,338	424,636,675
2.2	Instalimi i zërave më sipër + punime civile për rikonstruksionin e kabinave	254,888,593	254,888,593	254,888,593	254,888,593	509,777,187
2.3	Rikonstruksioni i n/stacionit Jagodinë (faza e parë)	36,000,000				36,000,000
2.4	Rrjet TU me përcjellës ABC në Tiranë	196,793,069				196,793,069
XII	Oponencë, supervizion, kolaudim	10,000,000				
XIII	Projekte N/Stacionesh	80,000,000				
XIV	Vlerë e parashikuar për shpronësim	10,000,000				
XV	Studime me të tretë për marrjen e lejeve të ndërtimit (topografik, gjeologjik, arkeologjik, mjedisor)	10,000,000				
XVI	Programe inxhinierike	20,000,000				
	TOTALI	8,757,419,274	7,718,648,616	8,433,130,828	7,471,380,872	4,706,967,672

VENDIM

Nr. 183, datë 20.8.2018

MBI MIRATIMIN E LICENCËS SË OPERIMIT TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “c”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.8.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, për miratimin e licencës së operimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 37, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ERE lëshon licencë për veprimtarinë e shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Enti Rregullator i Energjisë, me vendimin e Bordit nr. 152 datë 28.9.2017, filloi procedurën për draftimin dhe miratimin e licencës së operimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike. ERE, me shkresën nr. 649 prot., datë 4.10.2017, i është drejtuar palëve të interesit Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës, shoqërisë OSHEE sh.a., Shoqërisë KESH sh.a., Shoqërisë OST sh.a., Shoqatës AAES, Shoqatës AREA, Shoqatës së Prodhuesve të Vegjël të Energjisë Elektrike, Shoqatës FIAA, si dhe Shoqatës ACERC, për marrje mendimi dhe dhënien e objeksioneve.

- Shoqëria OSHEE sh.a. me shkresën nr. 22415/1 prot., datë 16.10.2017, bëri me dije se komentet, vërejtjet dhe sugjerimet e saj mbi këtë draft.

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. 5317/1 prot., datë 26.10.2017, kërkoi nga ERE që t'i përmbahet plotësisht përkufizimit që jep ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, në nenin 3, pika 48 për Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.).

- Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 393/1 prot., datë 9.11.2017, kërkoi nga ERE të



reflektojë në draft parashikimet e neneve 68 dhe 75, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” ndryshuar, si dhe të mbajë në konsideratë parashikimet e direktivës 2009/72/EC “Lidhur me Rregullat e përbashkëta në tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe shfuqizimin e direktivës 2003/54/EC”.

- ERE organizoi edhe një seancë dëgjimore në datën 5.1.2018, midis OST sh.a., OSHEE sh.a. dhe Autoritetit të Konkurrencës në lidhje me kushtet e licencës në veprimtarinë e operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Drafti i dakordësuar në seancë dëgjimore iu dërgua shoqërisë OSHEE sh.a., për të bërë mbi të ndërhyrjet përfundimtare. Nga ana e kësaj të fundit nuk pati një përgjigjeje apo një draft të ri të përmirësuar.

- ERE, gjithashtu, në datën 2.2.2018, i dërgoi për mendim Sekretariatit të Energjisë Elektrike draft licencën, por nuk ka një opinion të tij, në lidhje me draftin.

- ERE mori në konsideratë të gjitha rekomandimet e palëve të interesit që shprehën opinionin e tyre, si më sipër cituar, që ndihmonin në përmirësimin e këtij drafti, pa rënë ndesh me sa parashikuar në legjislacionin në fuqi për kushtet e licencës së operimit të sistemit të shpërndarjes.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë licencën e operimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike. (Bashkëlidhur këtij vendimi.)

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir Ahmeti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Republika e Shqipërisë Enti Rregullator i Energjisë

LICENCË

PËR VEPRIMTARINË E OPERIMIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

Seria: _____

Numri i licencës: _____

Data e hyrjes në fuqi: _____
(Vendim i ERE-s nr. _____, datë ____ . ____ . ____)

Licenca i jepet: _____
(Emri dhe adresa)

NUIS: _____
(seria, numri, vendi i regjistrimit)

Me autoritetin që i është dhënë sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neni 37, pika 2, germa “c”, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ia jep këtë licencë për veprimtarinë e operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike (“Licenca”), për kryerjen e veprimtarisë së shpërndarjes së energjisë elektrike, me tarifa të rregulluara, personit juridik të lartpërmendur, i quajtur “i licencuari”, subjekt i kushteve të licencës bashkëngjitur kësaj licence. Kjo licencë hyn në fuqi në datën e mësipërme dhe do të jetë në fuqi për një periudhë 30-vjeçare, deri sa të përfundojë apo të hiqet nga ERE në përputhje me kushtet e licencës të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

[Kryetari]

[Vula e ERE-s]



**Republika e Shqipërisë
Enti Rregullator i Energjisë**

**KUSHTET E LICENCËS
PËR VEPRIMTARINË E OPERIMIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES
SË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Seria: _____

Nr. i licencës _____

I jepet: _____

(Emri i plotë i të licencuarit)

1. Dispozita të përgjithshme

1.1 ERE është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur sipas pjesës së katërt të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, që lëshon transferon ose heq këtë licencë.

1.2 Nëse ndonjë kusht i kësaj licence pushon së qeni efektiv, ai kusht do të hiqet nga kushtet e licencës dhe kushtet e mbetura do të vazhdojnë të jenë në fuqi.

1.3 Kjo licencë, nuk do t’i transferohet tërësisht ose pjesërisht, asnjë personi juridik tjetër pa miratimin paraprak të ERE-s. Kur miraton një transferim, ERE mund ta modifikojë periudhën e licencës ose kushtet e tjera të licencës pasi të ketë arsyetuar vendimarrjen.

1.4 ERE ndryshon licencën, në përputhje me nenin 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe në rastet e mëposhtme:

a) Kur lind nevoja për garantimin e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, si dhe të rendit publik pas marrjes në konsideratë të qëndrimit të autoriteteve shtetërore kompetente;

b) Kur lind nevoja për të garantuar qëndrueshmërinë dhe furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të klientëve;

c) Kur rrezikohet jeta e qytetarëve, shëndeti i tyre, si dhe mjedisi ose pasuria e palëve të treta, në rastet kur ka rrezik; kur në licencë është bërë një gabim i qartë faktik/i provuar; ose

d) Kur ka një ndryshim në kuadrin ligjor lidhur me tregun e energjisë elektrike, përfshirë ndryshimet në kuadrin ligjor ose rregullat e zbatueshme për të licencuarin, që rrit materialisht koston e sigurimit të nivelit të shërbimit të kërkuar sipas kësaj licence.

1.5 I licencuari mund të kërkojë një modifikim të kësaj licence, në përputhje me nenin 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nëpërmjet një kërkesë të detajuar me shkrim, që domosdoshmërisht duhet të përmbajë një arsyetim për modifikimin e kërkuar.

1.6 I licencuari mund të parashtrojë në ERE një kërkesë me shkrim për rinovimin e licencës jo me vonë se 2 muaj para përfundimit të afatit të licencës së dhënë, duke kryer njëkohësisht edhe pagesën e aplikimit, siç parashikohet në rregulloren e posaçme.

1.7 Rinovimi i licencës bëhet nga ERE, bazuar në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, si dhe mbështetur në prova të besueshme, konkludon se:

a) I licencuari i ka përmbushur kushtet e licencës dhe i është përmbajtur kërkesave të gjitha ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme gjatë afatit të licencës;

b) Rrjeti i Shpërndarjes do të operojë në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme gjatë afatit të zgjatur dhe kjo do të jetë në përfitim të klientit apo përdoruesve;

c) Në rast se Bordi refuzon ta rinovojë licencën, deri në përfundim të saj, i licencuari:

i. Vetëm pas marrjes së miratimit nga ERE, mund t’ia transferojë pronësinë mbi asetet që përdor për kryerjen e veprimtarisë së licencuar një pale të tretë;

ii. Vetëm pas marrjes së miratimit nga ERE, mund t’ia transferojë operimin e veprimtarisë/ mjeteve të licencuarit një subjekti që në gjykimin



e ERE-s mund të ushtrojë veprimtarinë e licencuar;

iii. Në rast se nuk e transferon pronësinë e aseteve para datës së përfundimit të licencës dhe revokimi i licencës mund të rezultojë me rrezik për mbrojtjen kombëtare dhe sigurinë, rendin publik dhe furnizimin e pandërprerë të klientëve me energji elektrike, ERE merr vendim për të vendosur një administrator të përkohshëm të shoqërisë, së cilës i është hequr licenca, në mënyrë që të sigurohet ushtrimi i aktivitetit dhe operimi i aseteve të saj.

1.8 Sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, jepet vetëm një licencë për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, me tarifa të rregulluara në Republikën e Shqipërisë.

1.9 Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në licencë, në kushtet e licencës dhe në shtojca, do të kenë kuptimin e mëposhtëm apo kuptimin e parashikuar në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar:

Shërbimet ndihmëse	Janë shërbimet e nevojshme për operimin e qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes.
Biznesi shoqërues	Çdo biznes tjetër që direkt ose indirekt, tërësisht ose pjesërisht: 1. Është pronë e të licencuarit; ose 2. Ka pronësi të licencuarin; ose 3. Është në pronësi të një shoqërie, i cili është pronë e të licencuarit.
Ligji	Do të thotë ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” me të gjitha ndryshimet e bëra apo që mund të bëhen në të ardhmen e që në vijim do të përdoret shkurtimisht me emërtimin ligji për energjinë.
Pagesat për përdorimin e Rrjetit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Ndërsubvencionet	Tarifat që mund të vendosë i licencuari për përdorimin e Rrjetit të tij të Shpërndarjes, siç mund të miratohen nga ERE kohë pas kohe.
Shpërndarja	Transferim fondesh ose ndarje kostosh brenda llogarive të të licencuarit ose mes bizneseve shoqëruese për mbështetje financiare të një aktiviteti ose biznesi me koston e një tjetri.
Rrjeti i Shpërndarjes (RRSH)	Është transporti i energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes me tension të lartë, të mesëm dhe të ulët, me qëllim lëvrimin e saj te klientët fundorë, pa përfshirë furnizimin e klientëve.
Klient fundor	Është tërësia e linjave, nënstacioneve, pajisjeve të shpërndarjes së energjisë elektrike, përfshirë linjat e interkoneksionit.
Përdorues	Është një klient që blen energji elektrike vetëm për përdorim vetjak.
ERE	Janë personat fizikë ose juridikë, të cilët i furnizon ose furnizohen me energji elektrike nëpërmjet sistemit të shpërndarjes.
Legjislacioni në fuqi	Është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin e energjisë.
Sistemi i shpërndarjes	Ligjet e Republikës së Shqipërisë të shpallura nga Kuvendi shqiptar, si dhe legjislacioni sekondar që janë në fuqi gjatë kohëzgjatjes së kësaj licence.
Licencë për veprimtarinë operimi i sistemit të shpërndarjes të energjisë elektrike	Është sistemi i linjave, strukturave mbështetëse, pajisjeve transformuese dhe kyçëse/shkyçëse, të përdorura për shpërndarjen e energjisë elektrike dhe lëvrimin e saj te klientët, pa përfshirë furnizimin.
Veprimtaria e licencuar	Është autorizimi që i jepet një personi sipas përcaktimeve të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, me qëllim transportin e energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes me tension të lartë, të mesëm dhe të ulët, me qëllim lëvrimin e saj te klientët, pa përfshirë furnizimin.
I licencuari	Veprimtari të nevojshme dhe direkt të lidhura me operimin e një Rrjeti Shpërndarje me qëllimin e furnizimit me energji elektrike të klientëve fundorë. Veprimtaria e licencuar nuk përfshin aktivitetet e blerjes ose shitjes së energjisë elektrike dhe kapacitetit, të cilat kryhen për klientët fundorë nga i ngarkuari me detyrimin e shërbimit publik.
	Personi që mban këtë licencë për shpërndarje të energjisë elektrike që përmendet në faqen e parë të kësaj licence.



Personi	Person do të thotë çdo person juridik i krijuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Faktori i humbjeve të energjisë	Humbjet e vlerësuara të energjisë elektrike në rrjetin elektrik me një tension të caktuar të shprehura në përqindje të shumës totale të energjisë elektrike të lëvruar në rrjetin përkatës brenda periudhës përkatëse financiare.
Tarifa e rregulluar	Një tarifë aktualisht në fuqi dhe e miratuar nga ERE, sipas legjislacionit në fuqi dhe metodologjive të llogaritjes së tarifave të miratuara nga ERE.
Rregulloret dhe rregullat	Standardet, kodet, rregulloret, urdhrat dhe rekomandime të tjera ligjërish në fuqi, të miratuara nga ERE.
Prodhuës me përparësi	Janë prodhuësit e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të ligjit për energjitë e rinovueshme të energjisë elektrike.
Transferimi	Çdo shitje, dhënie me qira ose ndonjë formë tjetër e transferimit të të drejtave mbi asetet apo licencën, në veprimtarinë e licencuar.
Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ose (OSSH)	Është një person juridik, përgjegjës për operimin e sigurt, të besueshëm dhe të efektshëm të Rrjetit të Shpërndarjes, duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, të shtrirë në një zonë të caktuar dhe, kur është e aplikueshme, lidhjet e tij me sisteme të tjera për të siguruar aftësi afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe eficiencën e energjisë.
Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)	Është personi juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë Interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.
Operatori i rrjetit Të tjera	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes. Të gjithë termat e tjerë të përdorur në këtë licencë e që nuk gjenden në përkufizime, do të kenë kuptimin e parashikuar në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

2. Kryerja e veprimtarisë së licencuar

2.1 I licencuari autorizohet nga kjo licencë për kryerjen e veprimtarisë së licencuar. Kjo e drejtë i jepet ekskluzivisht të licencuarit.

2.2 Gjatë afatit të licencës, i licencuari duhet të kryejë të gjitha veprimtaritë që kërkojnë për përmbushjen e veprimtarisë së licencuar, përfshirë por pa u kufizuar në:

a) Ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen, sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe disponimin e aseteve si pjesë e Rrjetit me qëllim zhvillimin e Rrjetit të Shpërndarjes për sigurimin e furnizimit me energji elektrike të klientëve;

b) Lidhjen e klientëve dhe përdoruesve me Rrjetin e Shpërndarjes;

c) Instalimin dhe shërbimin e matësve të energjisë elektrike;

d) Treguesit e cilësisë.

2.3 I licencuari nuk do të vendosë pagesa për klientët dhe përdoruesit, të ndryshme nga ato për të cilat autorizohet nga ERE.

2.4 I licencuari nuk do të bashkëpunojë në asnjë mënyrë me të licencuar të tjerë lidhur me

veprimtarinë e licencuar në dëm të furnizuesve ose klientëve dhe përdoruesve ekzistues ose të ardhshëm.

2.5 I licencuari do t'i ndajë llogaritë e veta financiare brenda periudhës kohore të kërkuar nga legjislacioni në fuqi në mënyrë që t'i mundësojë ERE-s të konkludojë se nuk po ndodhin ndërsuvencione, veprimtari anti-konkurruese apo diskriminuese, përveç kur lejohet në mënyrë specifike nga ERE.

2.6 I licencuari nuk do të angazhohet në kryerjen e veprimeve ose në ndonjë aktivitet tjetër që shkakton antikonkurrencë, sipas legjislacionit në fuqi.

2.7 I licencuari do ta kryejë veprimtarinë e licencuar, në përputhje me parimet e eficiencës ekonomike dhe objektivin e arritjes së kostos me të ulët me standarde të përcaktuara të cilësisë dhe performancës.

2.8 I licencuari nuk do të angazhohet në veprimtari të tjera, që pengojnë ose mund të pengojnë kryerjen e veprimtarisë së licencuar.

2.9 I licencuari do të njoftojë ERE-n para se



të ndërmarrë ndonjë aktivitet, përveç aktivitetit të licencuar. ERE mund të marrë masa në lidhje me të licencuarin, nëse konstaton se po kryen ndonjë aktivitet të ndryshëm nga ai për të cilin është licencuar. ERE mund të pengojë kryerjen e ndonjë aktiviteti tjetër kur qëllimi është mbrojtja e shëndetit të njerëzve apo raste të tjera të natyrës së forcës madhore.

2.10 I licencuari do të informojë ERE-n për ngritjen e çdo biznesi shoqërues. ERE mund ta ndalojë ose të vendosë kushte për ngritjen e biznesit shoqërues, nëse është e nevojshme për mbrojtjen e klientëve të Republikës së Shqipërisë.

2.11 I licencuari nuk do të pengojë, parandalojë ose të përpiqet të parandalojë të licencuarit e tjerë apo konkurrentë potencialë që të angazhohen ligjërisht ose të hyjnë në biznesin e energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë.

3. Detyrimet e të licencuarit

3.1 I licencuari do të respektojë legjislacionin në fuqi gjatë ushtrimit të funksioneve sipas kësaj licence.

3.2 I licencuari do të ndërtojë dhe mirëmbajë Rrjetin e tij të Shpërndarjes me kapacitet të përshtatshëm për të plotësuar kërkesat për të gjithë klientët dhe përdoruesit e sistemit brenda Shqipërisë, mbi baza transparente, jo-diskriminuese dhe bazuar në tarifatat e miratuara dhe të publikuara nga ERE, përfshirë zgjerimin ose përmirësimin e faciliteteve të tij teknike sipas nevojës.

3.3 I licencuari do të hartojë dhe nxisë politika dhe programe për arritjen e një niveli të lartë të cilësisë dhe qëndrueshmërisë së Shërbimeve të Shpërndarjes, sipas Rregullave të ERE-s, në përputhje edhe me planin 5-vjeçar të investimeve, që duhet të hartojë, në zbatim të nenit 75, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

3.4 I licencuari do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për përmirësimin e eficiencës operative dhe ekonomike të veprimtarisë së licencuar, me qëllim që të sigurojë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të shpërndarjes në përfitim të klientëve, dhe sipas Kodit të Shpërndarjes.

3.5 I licencuari do të përmbushë gjithë Rregullat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të miratuara nga ERE dhe kërkesat për paraqitjen e informacionit teknik dhe gjithë

dokumentacionit tjetër sipas parashikimeve të Kodit të Rrjetit dhe Rregullave të Tregut. Për të lehtësuar kryerjen e veprimtarive të licencuara, i licencuari në rastin kur vlerëson rëndësinë që kanë asetet e lidhjes, në zhvillimin e sistemit të shpërndarjes apo kur këto asete i shërbejnë më shumë se një klienti, ka të drejtën e marrjes në pronësi të një pjese ose të gjithë lidhjes së ndërtuar nga ana e përdoruesit, sipas legjislacionit civil, kundrejt një kompensimi të plotë të kostove të llogaritura në përputhje me ligjin në fuqi dhe rregulloren e lidhjeve të reja.

4. Llogaritë dhe raportimi

4.1 I licencuari do të mbajë regjistra llogarie dhe do të përgatisë pasqyra financiare, që do të mbahen më vete për veprimtarinë e licencuar dhe çdo veprimtari tjetër ku është angazhuar i licencuari, në përputhje me legjislacionin në fuqi për standardet e kontabilitetit, ligjit të energjisë dhe parimeve ndërkombëtare financiare. I licencuari është i detyruar, gjithashtu, të depozitojë kopjen e audituar të pasqyrave financiare, brenda datës 30 qershor të vitit pasardhës.

4.2 Të licencuarit i kërkohet të përgatisë dhe t'i paraqesë ERE-s, më 31 janar të çdo viti, një raport vjetor lidhur me operimet e tij gjatë vitit të mëparshëm kalendarik, që përmban sa më poshtë:

- a) Përmbledhjen dhe analizën e veprimtarisë së shpërndarjes së të licencuarit;
- b) Shitjet e energjisë elektrike dhe të dhënat mbi mbledhjen e faturave për vitin;
- c) Cilësinë e shërbimit të shpërndarjes dhe detajet e çdo mase të marrë për përmirësimin e shërbimit të shpërndarjes në zonë;
- d) Çdo keqfunksionim që ndodh gjatë vitit;
- e) Çdo ndërprerje të programuar dhe të paprogramuar të energjisë elektrike sipas niveleve të tensionit;
- f) Humbjet sipas niveleve të tensionit.

4.3 I licencuari do t'i paraqesë ERE-s, me kërkesën e saj dhe sipas formës dhe brenda kohës së vendosur nga ERE, çdo informacion që është i nevojshëm për ERE-n për të përmbushur funksionin e saj rregullator.

4.4 I licencuari do t'i ndajë shpenzimet e përbashkëta mes veprimtarisë së tij të licencuar dhe llojeve të tjera të veprimtarive (përfshirë veprimtaritë e licencuara) në bazë të arsyeshme,



në mbështetje të parashikimeve të nenit 72 të ligjit të energjisë, për ndarjen e veprimtarisë së operatorit të shpërndarjes së energjisë elektrike. I licencuari do t'i paraqesë ERE-s, dokumentacionin që përcakton bazat për ndarjen e shpenzimeve të përbashkëta, si dhe rezultatet e arritura.

4.5 I licencuari do ta njoftojë ERE-n brenda 10 ditëve kalendarike për çdo ndryshim, të:

- a) Adresës;
- b) Statutit të të licencuarit;
- c) Certifikatës së regjistrimit;
- d) Kodit fiskal;
- e) Organeve drejtuese apo drejtuesve të lartë;

ose

f) Aksionarëve që posedojnë mbi masën 5% të aksioneve.

4.6 Gjithë njoftimet zyrtare, aplikimet, petitionet dhe pretendimet që lidhen me licencën duhet të jenë me shkrim, të ekzekutohen në kohën e duhur nga një zyrtar i autorizuar ose një përfaqësues i zgjedhur i të licencuarit dhe të shpërndahen me korrier ose me postë të regjistruar, duke kërkuar verifikimin e faturës. Adresat e palëve duhet të duken mbi zarf. Të gjitha njoftimet ose korrespondenca tjetër do të konsiderohen se hyjnë në fuqi nga momenti i shpërndarjes ose, nëse nuk janë shpërndarë për shkak të gabimit të dërguesit, nga momenti i paraqitjes.

4.7 Përdorimi i informacionit

4.7.1 Sipas ligjit të energjisë elektrike, Kodit të Transmetimit, Kodit të Shpërndarjes, Rregullave të Tregut dhe kërkesave të rregulloreve përkatëse, i licencuari do të sigurojë që çdo informacion i marrë nga të tjerët si rezultat i veprimtarisë së tij të licencuar nuk do t'i zbulohet askujt, përveç:

- a) Me pëlqimin paraprak me shkrim të personit me çështjet e të cilit lidhet informacioni;
- b) Kur informacioni është tashmë i njohur për publikun;
- c) Kur të licencuarit i kërkohet ose i lejohej ta përhapë informacionin për të përmbushur kushtet e kësaj licence, çdo urdhër të ERE-s dhe legjislacionit në fuqi.

4.7.2 I licencuari do të sigurojë që asnjë biznes shoqërues nuk do të përdorë informacionin në pronësi të të licencuarit për të fituar përparësi konkurruese të pajustifikuara dhe do të sigurojë se

nuk do të përhapë asnjë informacion ndonjë personi tjetër (përfshirë ata të një biznesi tjetër shoqërues) që mund ta mundësojë këtë person të arrijë çdo lloj përparësie tregtare të pajustifikuara.

4.7.3 Me kërkesën e ERE-s, i licencuari do të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për ta mbrojtur informacionin konfidencial që posedon dhe do t'i paraqesë ERE-s raporte që lidhen me respektimin e detyrimeve.

4.7.4 Informacioni që i sigurohet ERE-s nga i licencuari do të konsiderohet publik, përveç, kur me kërkesë të veçantë të të licencuarit, ERE me vendim siguron se ky informacion është i natyrës pasurore dhe se interesi publik të cilit i shërbehet nga përhapja e tij nuk do ta justifikojë ose kompensojë dëmin tregtar, potencial, ndaj të licencuarit.

5. Pagesat e rregullimit

5.1 I licencuari do të paguajë rregullisht dhe në mënyrë të vazhdueshme pagesat e rregullimit gjatë kohëzgjatjes së kësaj licence, siç përcaktohet me vendim nga ERE, në zbatim të nenit 17, pika 4, të ligjit të energjisë dhe rregulloreve të ERE-s për pagesat e rregullimit.

5.2 Nëse i licencuari nuk i paguan ERE-s pagesat e rregullimit brenda periudhës së kërkuar, i licencuari mund të penalizohet sipas dispozitave të parashikuara në nenit 107 të ligjit të energjisë dhe Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave.

6. Tarifa e përdorimit të sistemit të shpërndarjes

6.1 Tarifa e përdorimit të sistemit të Shpërndarjes do të rregullohet dhe miratohet nga ERE, në përputhje me Metodologjinë e Llogaritjes së Tarifës së Shpërndarjes. I licencuari do të kërkojë axhustimin/korrigjimin kohe pas kohe të tarifës së përdoruesit për të pasqyruar koston reale.

6.2 Pagesa totale e përdoruesit do të përcaktohet në bazë të tarifës së aksesit dhe sasisë së energjisë elektrike të regjistruar nga matësit e instaluar në kufijtë mes Rrjetit të Shpërndarjes dhe klientëve të lidhur me Rrjetin e Shpërndarjes, sipas Kodit të Matjes.

6.3 Tarifa e aksesit, e miratuar nga ERE, do të vendoset në zbatim të metodologjisë për llogaritjen e tarifave të OSSH-së duke marrë në konsideratë sigurimin e:



a) Të ardhurave të mjaftueshme për të mbuluar nivelet e arsyeshme të kostove operative dhe investimeve të justifikuara dhe të kujdesshme të realizuara, si dhe fitimeve të arsyeshme;

b) Nxitjes për reduktimin e kostove dhe operimin në mënyrë eficiente;

c) Uljen e humbjeve.

6.4 I licencuari do të paraqesë raporte mbi tarifat sipas kërkesave të metodologjisë së llogaritjes së tarifës së shpërndarjes të ERE-s. I licencuari mund të sugjerojë ndryshime në metodën e ndarjes së kostove që përdoret për të përcaktuar tarifat e zbatueshme për përdoruesit e Rrjetit të Shpërndarjes, dhe që do ta lejonin të licencuarin të shlyejë kostot e arsyeshme dhe sigurimin e një kthimi të arsyeshëm për kryerjen e këtyre shërbimeve. Metodologjia e ndarjes së kostove dhe çdo ndryshim i saj do të konsiderohet efektive vetëm pas miratimit të saj nga ERE.

6.5 I licencuari mund të kërkojë pagesë sigurie të arsyeshme nga klientët sipas detyrave dhe përgjegjësisë së tij gjatë veprimtarisë së tij të licencuar, sipas Rregullave të ERE-s. Detyrimet e sigurisë do të deklarohen qartë në kontratë mes të licencuarit dhe klientëve apo përdoruesve të Rrjetit të Shpërndarjes.

6.6 I licencuari mund ta shkëpusë një klient për mos-pagesë të faturave elektrike, sipas Rregullave të miratuara nga ERE. I licencuari do ta rilidhë klientin apo përdoruesin pas marrjes së konfirmimit se klienti ka paguar detyrimin në fjalë, sipas Rregullave të ERE-s.

6.7 Aksesit në Rrjetin e Shpërndarjes

6.7.1 I licencuari do t'u sigurojë akses në Rrjetin e Shpërndarjes për t'u lidhur dhe për të përdorur asetet e Rrjetit të Shpërndarjes, klientëve dhe përdoruesve të tij në bazë të drejtë, të arsyeshme dhe jodiskriminuese.

6.7.2 I licencuari mund të refuzojnë aksesin në rrjet, në rast se mungon kapaciteti i nevojshëm. Vendimi për refuzimin e aksesit në rrjet duhet të jetë i arsyetuar, të bazohet në kushte teknike dhe ekonomike objektive dhe duhet të marrë në konsideratë detyrimin e shërbimit publik, si dhe detyrimet për mbrojtjen e klientëve fundorë, të përcaktuara nga ligji. Vendimi për refuzimin e aksesit i njoftohet palës së interesuar.

6.7.3 I licencuari nuk do të hyjë në asnjë marrëveshje që mund të rezultojë në shkelje të kushteve të licencës ose të ndonjë dispozite të Kodit të Shpërndarjes.

6.7.4 I licencuari do t'u kërkojë përdoruesve të rinj të Rrjetit të Shpërndarjes të paguajnë pagesa të zbatueshme për lidhjen. Gjatë kryerjes së veprimtarisë së licencuar, i licencuari do t'i trajtojë përdoruesit e Rrjetit të Shpërndarjes brenda së njëjtës kategori apo nivel tensioni, në mënyrë të drejtë dhe jodiskriminuese, konform legjislacionit në fuqi.

6.7.5 I licencuari, sipas Kodit të Shpërndarjes dhe rregulloreve të tjera përkatëse, mund t'i pezullojë shërbimet e tij të siguruara sipas kësaj licence për çdo periudhë gjatë së cilës veprimi ose mosveprimi i një ose më shumë përdoruesve të Rrjetit të Shpërndarjes së energjisë elektrike kërcënon sigurinë, qëndrueshmërinë ose cilësinë e operimeve të Rrjetit të Shpërndarjes ose shërbimet e siguruara klientëve ose furnizuesve të tjerë, ose parandalon ose pengon kryerjen e veprimtarisë së licencuar nga i licencuari ose gjatë situatave të emergjencës së furnizimit me energji elektrike, siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi. Kur i licencuari vepron sipas kësaj pike, do t'ia raportojë dhe informojë ERE-s brenda 24 orëve.

6.8 Një mosmarrëveshje mes të licencuarit dhe përdoruesit të Rrjetit të Shpërndarjes, dhe/ose një të licencuari tjetër lidhur me një çështje brenda juridiksionit të ERE-s, që nuk mund të zgjidhet nëpërmjet negociatave të kryera mes palëve, do të adresohet në ERE për t'u zgjidhur sipas kushteve të përcaktuara në Rregulloren për trajtimin e ankesave dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes të licencuarve.

6.9 Një vendim i ERE-s mund të ankimohet në ERE brenda 7 ditëve kalendrike nga data e marrjes dijeni në ERE dhe brenda 30 ditëve kalendrike në Gjykatën Administrative Tiranë, sipas legjislacionit në fuqi nga data e publikimit të vendimit në Fletoren Zyrtare.

7. Matja e energjisë elektrike dhe humbjet

7.1 I licencuari do të sigurojë leximin e matësve të vendosur në rrjetin e shpërndarjes.

7.2 I licencuari do të sigurojë sistemin e matjes për klientët dhe përdoruesit e sistemit të shpërndarjes, përfshirë furnizuesit, në baza jodiskriminuese dhe konfidenciale dhe do të kompensohet në mënyrë të arsyeshme për kostot



përkatëse nga tarifat e përndarimit të sistemit të shpërndarjes.

7.3 I licencuari:

a) Do të sigurojë veprimtarinë matëse dhe shërbimin e leximit të matësve, konform legjislacionit në fuqi;

b) Do të bëjë vlerësimin e sasisë së energjisë së konsumuar nga klientët për të cilët nuk merren leximet aktuale të matësit ose ato nuk përputhen saktësisht me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e ERE-s, por i licencuari do t'i minimizojë në maksimum rastet kur kërkohen vlerësime;

c) Do të përcaktojë konsumin orar të energjisë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesit nëpërmjet matjes, vlerësimit të konsumit orar të ngarkesës ose me çdo metodë tjetër të pranueshme;

d) Do të marrë miratimin e ERE-s për metodat dhe procedurat e përdorura për përcaktimin dhe vlerësimin e konsumit të energjisë elektrike.

7.4 I licencuari është përgjegjës për blerjen e gjithë energjisë së nevojshme për të mbuluar humbjet në sistemin e shpërndarjes.

7.5 I licencuari duhet të përgatisë një program për të arritur uljen e nivelit të humbjeve, ashtu siç është përcaktuar në metodologjinë e llogaritjes së tarifave të shpërndarjes apo nga ndonjë vendim tjetër i ERE-s.

7.6 I licencuari do të bashkëpunojë me Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe do të sigurojë gjithë informacionin, lidhur me operimin e Rrjetit të Shpërndarjes të kërkuar nga OST-ja. Kur leximet e matësve ose verifikimet duhen kryer nga OST-ja në përputhje me legjislacionin në fuqi, i licencuari do ta lehtësojë aksesin në leximin e matësve brenda vendndodhjes së kompanisë së shpërndarjes.

8. Programi i zhvillimit të Rrjetit të Shpërndarjes

8.1 I licencuari do të përgatisë dhe do t'i paraqesë ERE-s për miratim në përputhje me Rregulloren e procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, një program zhvillimi të rrjetit që mbulon jo më pak se 5 (pesë) vjet.

8.2 Programi duhet fokusuar në zhvillimin dhe rehabilitimin e Rrjetit të të licencuarit me

qëllim përmirësimin e shërbimit ndaj klientëve. Duhet të përfshijë, por nuk do të kufizohet në sa më poshtë:

a) Eficiencën e energjisë;

b) Menaxhimin e kërkesës;

c) Zhvillimin apo përmirësimin e sistemit të shpërndarjes;

d) Informacion për mjetet financiare të siguruara për investimet në sistemin e shpërndarjes.

8.3 Plani i Rrjetit nuk duhet të diskriminojë në mënyrë të paarsyeshme mes kategorive të klientëve. I licencuari do t'i paraqesë ERE-s një herë në gjashtë muaj, një raport që tregon aktivitetet e tij lidhur me planin e zhvillimit.

8.4 ERE, mund të zhvillojë seanca dëgjimore në përfundim të të cilave mund të kërkojë ndryshime në programin e zhvillimit të sistemit/rrjetit, kur këto ndryshime kërkohen për të siguruar plotësimin e detyrimeve sipas kësaj licence.

9. Monitorimi dhe kontrollet mbi performancën e veprimtarisë së licencuar

9.1 ERE do të monitorojë respektimin nga i licencuari të kushteve të licencës, do të rishikojë raportet e marra nga i licencuari dhe është e autorizuar që të inspektojë në çdo kohë regjistrat financiarë të të licencuarit dhe mund të kërkojë një auditim teknik dhe/ose financiar të veprimtarive të të licencuarit.

9.2 Përfaqësuesit e autorizuar të ERE-s mund të hyjnë në ambientet, pajisjet dhe dokumentet e të licencuarit, për të inspektuar veprimtarinë e licencuar sipas Rregullave të ERE-s. I licencuari do të japë çdo ndihmë të kërkuar nga ERE gjatë këtij inspektimi.

9.3 Në bazë të ankesës së konfirmuar të çdo pale të tretë ose me iniciativën e saj, ERE mund të nisë një hetim për respektimin nga i licencuari të kushteve të licencës ose rregullave të ERE-s.

9.4 Nëse pas hetimit, ERE konkludon se i licencuari nuk i ka respektuar kushtet e licencës, ERE mund t'i rishikojë tarifat e të licencuarit dhe/ose të ndërmarrë veprime të tjera brenda autoritetit të saj, me qëllim që të mbrojë interesat e përdoruesve dhe klientëve ose të sigurojë përmbushjen e afateve dhe kushteve të kësaj licence.

9.5 I licencuari do ta informojë dhe sqarojë ERE-n për çdo shkelje të kushteve të licencës, jo



me vonë se 7 ditë kalendarike pasi kjo shkelje është konstatuar.

9.6 I licencuari do të zbatojë vendimet e nxjerra nga ERE, përfshirë pagesat e gjobave të vena nga ERE, sipas legjislacionit në fuqi.

10. Prokurimi ekonomik i aseteve dhe shërbimeve

10.1 I licencuari duhet të prokurojë asetet dhe shërbimet nga burimet më ekonomike duke pasur parasysh sasinë dhe natyrën e aseteve dhe shërbimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

10.2 I licencuari të përgatisë dhe të mirëmbajë regjistrin e aseteve.

10.3 I licencuari nuk do të shpërndajë apo të zvogëlojë kontrollin e veprimtarisë mbi ndonjë aset të domosdoshëm, pa miratimin e ERE-s.

11. Operimi dhe mirëmbajtja e rrjetit

11.1 I licencuari merr përsipër operimin e Rrjetit të Shpërndarjes në mënyrë që të sigurojë shpërndarjen e energjisë elektrike, nëpërmjet një rrjeti të sigurt dhe të qëndrueshëm, sipas legjislacionit në fuqi:

a) Duke përdorur pajisje që plotësojnë kushtet teknike, rregullat dhe standardet e sigurisë;

b) Duke përdorur një numër të përshtatshëm personeli, të aftë për të punuar për operimin dhe mirëmbajtjen e Rrjetit të Shpërndarjes;

c) Duke përmblusur standardet kombëtare, ndërkombëtare dhe të BE-së, të miratuara për zbatim në Republikën e Shqipërisë, dhe gjithë rregulloret e tjera teknike dhe standardet e miratuara nga organizmat kompetentë.

11.2 I licencuari merr përsipër kryerjen e rehabilitimit dhe zhvillimit të Rrjetit të Shpërndarjes me qëllim që të përmirësojë shërbimin e shpërndarjes, sipas programeve ose planeve të miratuara nga ERE.

11.3 I licencuari do t'i përmbahet legjislacionit në fuqi kur kryen aktivitetet e tij për projektimin dhe ndërtimin e aseteve të Rrjetit të Shpërndarjes.

11.4 Pajisjet e blera nga i licencuari, me qëllimin e rehabilitimit dhe rindërtimit të Rrjetit të Shpërndarjes duhet të kenë specifikime më të mira performance se sa pajisjet ekzistuese dhe të jenë në përputhje me standardet e BE-së.

11.5 Në rast defekti ose shkëputje, i licencuari duhet ta rregullojë/riparojë Rrjetin e Shpërndarjes brenda periudhës kohore më të

shkurtër të mundshme. Nëse fajin për vonesën e ka i licencuari, ai do të mbajë përgjegjësi para përdoruesit të Rrjetit të Shpërndarjes sipas kushteve të përgjithshme të kontratave të zbatueshme për shërbimin e shpërndarjes.

11.6 I licencuari do ta menaxhojë Rrjetin e Shpërndarjes në mënyrë që të përmbushen dhe të ndiqen udhëzimet e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) dhe të jenë gjithnjë në përputhje me Kodin e Rrjetit.

11.7 I licencuari do t'i komunikojë OST-së pa vonesë gjithë ngjarjet dhe ndryshimet, përfshirë defektet dhe shkëputjet që mund të ndikojnë mbi operimin ose integritetin e Rrjetit të Transmetimit dhe sistemit të energjisë elektrike, kur i licencuari merr dijeni për këto ngjarje. I licencuari do t'i sigurojë OST-së çdo informacion të kërkuar në respektim rregullave të miratuara nga ERE.

11.8 Me qëllimin e operimit, facilitetetet e të licencuarit duhet të përshtaten me pajisjet teknike të telekomunikimit, matjes së largët, sinjalizimit dhe kontrollit defekt-masa parandaluese, si dhe sistemit SCADA. I licencuari do të sigurojë ambientet e kërkuara, furnizimin me energji elektrike, ajrin e kondicionuar, shërbimin teknik dhe operativ të pajisjeve. I licencuari do të projektojë, instalojë dhe sigurojë mirëmbajtjen teknike të releve të mbrojtjes dhe pajisjeve të automatizuara që kërkojnë për operimin e qëndrueshëm të sistemit të Shpërndarjes sipas kërkesave të kodeve të rrjetit.

12. Kontrolli operues

12.1 I licencuari do të sigurojë koordinimin dhe kontrollin e operimit të Rrjetit të Shpërndarjes dhe do t'i kryejë funksionet e veta në përputhje me rregullat e Rrjetit, legjislacionin në fuqi dhe udhëzimet e OST-së.

12.2 I licencuari do të nxjerrë udhëzime verbale ose me shkrim për personelin operues në detyrë të aseteve të Rrjetit, për furnizuesit dhe prodhuesit e lidhur direkt me Rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike. Këto udhëzime janë të detyrueshme për ta. Udhëzimet e të licencuarit së bashku me udhëzimet e OST-së do të regjistrohen në një regjistër operimi, që duhet mbajtur për një periudhë prej të paktën [6-mujsh] dhe i bëhen të disponueshme ERE-s me kërkesë.



12.3 I licencuari do të mbajë një regjistër dhe dokumente të tjera për punën e tij operative. Departamentet e menaxhimit të të licencuarit do të përcaktojnë tipin e dokumenteve operuese, procedurat dhe kushtet e përgatitjes së tyre siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

12.4 I licencuari - ka detyrimin të instalojë sistemin e teknologjive *online* të besueshmërisë dhe transparencës në përputhje me politikat zhvillimore të të licencuarit.

13. Shkëputja dhe ndërprerja e furnizimit me energji elektrike

13.1 I licencuari mund ta ndërpresë ose ta kufizojë shpërndarjen e energjisë elektrike, pa e njoftuar më parë klientin, sipas udhëzimeve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, dhe me vendimin e tij:

a) Nëse shëndeti dhe jeta e njerëzve janë në rrezik;

b) Nëse integriteti i Rrjetit të Shpërndarjes vihet në rrezik;

c) Kur ka rrezik për dëmtim të rëndë të rrjetit ose pronësisë së blerësve të tjerë;

d) Në rastet e emergjencës.

13.2 I licencuari do të njoftojë klientin në mënyrë të përshtatshme dhe jo më vonë se afati i vendosur në aktet nënligjore të ERE-s, mbi arsyen e kufizimeve ose ndërprerjeve të shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe mbi periudhën kohore të kufizimit ose ndërprerjes.

13.3 I licencuari ka të drejtë ta ndërpresë shpërndarjen e energjisë elektrike për një periudhë të arsyeshme kohe për qëllimet e kryerjes së riparimeve, shkyçjen operuese dhe vënien në punë të pajisjeve të reja të planifikuara. Në këto raste i licencuari do të njoftojë furnizuesin për kohën e fillimit dhe zgjatjen e ndërprerjes të paktën 7 ditë kalendrike para datës së veprimit nëpërmjet një njoftimi në media.

13.4 I licencuari me kërkesë të furnizuesit, ka të drejtë ta ndërpresë furnizimin me energji elektrike, pas njoftimit paraprak me shkrim:

a) Kur klienti konsumon energji elektrike, por nuk zbaton kushtet e kontratës;

b) Kur klienti nuk ka paguar në kohë shumat e duhura për energjinë elektrike të përdorur siç kërkohet nga kushtet kontraktore për shërbimet e shpërndarjes;

c) Gjatë një kontrolli dhe pas verifikimit rezultojnë se për fajin e klientit:

i. matësi nuk punon, gjë që ka shkaktuar mungesën e leximit, leximin e gabuar ose të pasaktë dhe/ose matjen e pasaktë të energjisë elektrike;

ii. skema e lidhjes është prishur, gjë që mund të çojë ose ka çuar në mungesën e leximit, leximin e gabuar ose të pasaktë të matësit;

iii. vulat, shenjat ose ndonjë mekanizëm tjetër kontrolli, të vendosura nga i licencuari ose ndonjë organizëm shtetëror i autorizuar, janë dëmtuar ose shkatërruar.

d) Klienti:

i. ka përdorur energji elektrike që nuk është matur me matës;

ii. ka lejuar klientë të rinj të energjisë elektrike që të lidhen në linjën e tij pa njoftuar dhe pa marrë leje nga i licencuari;

iii. nuk i siguron akses personelit të të licencuarit për të lexuar ose kontrolluar matësin.

e) Në çdo situatë tjetër që vlerësohet nga i licencuari.

13.5 Afati për kryerjen e pagesës, në njoftimin me shkrim, nuk do të jetë më i shkurtër se 7 (shtatë) ditë kalendrike pas datës së marrjes së njoftimit nga klienti. Njoftimi për pagesën do të përmbajë informacion mbi arsyen e vendosjes së pagesës, mbi shumat e detyrueshme, periudhën kohore për interesat e detyrueshme dhe afatin e pagesës.

13.6 Ndërprerja e furnizimit me energji elektrike sipas këtij parashikimi do të zgjasë deri sa klienti të shmangë arsyen që justifikonte ndërprerjen, dhe në këtë rast shërbimi do të rikthehet jo më vonë se 48 orë pas shmangies së arsyes.

14. Cilësia e shërbimit

14.1 I licencuari do ta planifikojë, operojë dhe zhvillojë Rrjetin, duke siguruar cilësinë e shërbimit sipas rregullave të Rrjetit dhe Kodit të Shpërndarjes të miratuar nga ERE.

14.2 Gjatë kryerjes së veprimtarisë së licencuar, i licencuari do të drejtohet nga treguesit e cilësisë së shërbimit dhe investimet e detyrueshme për zhvillimin e Rrjetit të Shpërndarjes të vendosura në planet e miratuara nga ERE.

14.3 I licencuari do t'i paraqesë çdo vit ERE-s një raport që përshkruan performancën e tij



lidhur me treguesit e cilësisë së shërbimit, të cilët miratohen nga ERE.

15. Marrëdhëniet me klientët

15.1 I licencuari do të hartojë dhe ERE miraton, afatet dhe kushtet e përgjithshme që rregullojnë marrëdhëniet e tij me përdoruesit e rrjetit dhe furnizuesit.

15.2 I licencuari do t'i bëjë të dukshme afatet dhe kushtet e përgjithshme që rregullojnë marrëdhëniet e tij me klientët në të gjitha zyrat e tij, do t'i publikojë në faqen e tij të internetit, dhe do t'u japë klientëve mundësinë të marrin një kopje të tyre.

15.3 I licencuari do të publikojë, do të vendosë në faqen e tij të internetit dhe do t'u japë klientëve informacion të detajuar mbi tarifën e energjisë elektrike për kategori të ndryshme klientësh.

15.4 I licencuari do t'u japë klientëve fatura të detajuara sipas kërkesës, dhe do të mbajë dokumentacion të mjaftueshëm për të mbështetur shumat e faturuara.

15.5 I licencuari do të krijojë në strukturën e shoqërisë një njësi të dedikuar për marrëdhëniet me klientët. I licencuari duhet të punësojë një numër të mjaftueshëm personeli të kualifikuar

15.6 Brenda 6 (gjashtë) muajve pas datës së hyrjes në fuqi të licencës, i licencuari do të përgatisë rregulla për të trajtuar ankesat e përdoruesve të rrjetit dhe do t'ia paraqesë këto rregulla ERE-s. Rregullat do të përfshijnë të paktën sa më poshtë:

a) Të dhëna mbi organizimin e njësive të dedikuara, përfshirë vendndodhjen, orët e punës, orët për takimet me klientët, numrin e telefonit të kontaktit etj.;

b) Afatet dhe kushtet për lidhjen e përdoruesve të rrjetit me Rrjetin e Shpërndarjes, aplikimet për hetimin e kushteve dhe procedurat për lidhjen e klientëve me Rrjetin e Shpërndarjes, periudhat e kontrollit dhe përgjigjes, procedurën e refuzimit, përfshirë paraqitjen e formave të aplikimit etj.;

c) Kërkesat minimale teknike për lidhjen e faciliteteve të gjeneratorëve të pavarur, instalimeve dhe rrjeteve të klientëve në Rrjetin e Shpërndarjes;

d) Afatet dhe kushtet për përfundimin e kontratave për shitje të energjisë elektrike me kushte të përgjithshme;

e) Afatet dhe kushtet për të paraqitur pretendimet, aplikimet dhe propozimet;

f) Procedurat dhe afatet për hetimin dhe përgjigjen ndaj ankesave, aplikimeve dhe propozimeve të regjistruara.

15.7 Proceset dhe rregullat e vendosura sipas paragrafit “F” më lart, do të bëhen publikisht të disponueshme, përfshirë faqen e internetit të të licencuarit dhe do t'u jepen klientëve me kërkesë pa pagesë.

15.8 I licencuari do të mbajë dokumentacionin që përmban gjithë ankesat, aplikimet dhe propozimet dhe përgjigjet për secilën prej tyre për një periudhë 3-vjeçare (trevjeçare) pas datës së marrjes ose përgjigjes, kushdo qoftë më e vonshme.

15.9 I licencuari do të ngrejë një sistem për regjistrimin dhe trajtimin e ankesave, aplikimeve dhe propozimeve të klientëve.

15.10 I licencuari do të marrë në konsideratë çdo ankesë dhe do t'i përgjigjet me shkrim ankuesit për ta këshilluar nëse ankesa e tij/saj është pranuar apo refuzuar, brenda 15 ditëve pune nga marrja e saj.

15.11 Në rast se i licencuari nuk përgjigjet brenda periudhës së treguar ose përgjigja nuk e kënaq ankuesin, ankesat, aplikimet dhe propozimet mund t'i adresohen ERE-s. Nëse ERE, pas marrjes së mendimit të të licencuarit, vendos se ankesa specifike është e justifikuar, do t'i japë të licencuarit udhëzime të detyrueshme për zbatim.

15.12 I licencuari do t'i paraqesë ERE-s raport periodik 3-mujor dhe në raportin e tij vjetor, informacion të detajuar lidhur me:

a) Numrin total të ankesave, aplikimeve dhe propozimeve gjatë vitit të kaluar kalendarik;

b) Ndarjen e ankesave, aplikimeve dhe propozimeve sipas kategorive si mosplotësimi i aplikimeve për shërbime, cilësia e shërbimit etj.; dhe

c) Mënyrën për zgjidhjen e ankesave, si: ngarkimi për riparimin ose kompensime paguar ankuesve dhe arsyet e refuzimit të ankesave etj.

16. Siguria në punë dhe operimi i sigurt i rrjetit

16.1 I licencuari do ta operojë, mirëmbajë dhe zhvillojë Rrjetin e Shpërndarjes, në mënyrë që çdo rrezik i parashikuar për personelin, klientët ose persona të tjerë, si dhe pajisjeve të rrjetit



shpërndarës, të eliminohet në shkallën më të lartë të mundshme në kushte normale operimi dhe në raste defektesh.

16.2 I licencuari do të përmbushë gjithë kërkesat aktuale teknike, rregulloret dhe standardet lidhur me:

a) Operimin dhe mirëmbajtjen e Rrjetit të Shpërndarjes, pajisjeve dhe aseteve të përdorura për kryerjen e veprimtarisë së licencuar;

b) Operimin dhe mirëmbajtjen e matësve; dhe

c) Riparimet e sistemit.

16.3 Lidhur me performancën e tij sipas paragrafit të mësipërm i licencuari:

a) Do të hartojë dhe zbatojë manuale të brendshme për operimin e Rrjetit të Shpërndarjes dhe aseteve;

b) Do të punësojë një numër personeli të kualifikuar për operimin dhe mirëmbajtjen e Rrjetit, instalimeve, pajisjeve, faciliteteve dhe matësve.

16.4 I licencuari është i detyruar të zbatojë kërkesat e legjislacionit në fuqi, për shëndetin dhe sigurinë në punë.

17. Situatat e emergjencës

17.1 I licencuari nuk do të konsiderohet se i ka shkelur kushtet e kësaj licence në rast se ndalohet në përmbushjen e tyre nga forca madhore ose rrethana të tjera emergjence.

17.2 Në kushtet e emergjencës, i licencuari:

a) Do të ndërmarrë veprimet e duhura për të garantuar qëndrueshmërinë, mirëmbajtjen dhe operimin e Rrjetit të Shpërndarjes;

b) Do të sigurojë bashkëpunimin e nevojshëm me autoritetet dhe institucionet përgjegjëse për të vepruar në situatë emergjence, me qëllim që të rifillojë shpërndarjen e energjisë elektrike brenda një periudhe kohore sa më të shkurtër;

c) Do të plotësojë detyrimet e tij për reduktimin e rreziqeve dhe humbjeve lidhur me jetën, shëndetin dhe pronën e palëve të treta;

d) Do të marrë masa të menjëhershme për të marrë pjesë brenda një periudhe kohore sa me të shkurtër në restaurimin e Rrjetit të Shpërndarjes që është shkatërruar ose dëmtuar si rezultat i këtyre rrethanave të emergjencës;

e) Brenda 24 orëve nga ngjarja që përbën emergjencë, i licencuari do të njoftojë ERE-n për situatën e emergjencës dhe veprimet që do të ndërmarrë për ta kthyer sistemin në operim normal.

17.3 Nëse i licencuari e parashikon situatën e emergjencës siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi, i licencuari do të njoftojë ERE-n brenda 24 orëve dhe ky njoftim do të përshkruajë se çfarë hapash do të marrë i licencuari për të mënjeluar ose përmirësuar ndikimet e situatës emergjente të parashikuara.

18. Heqja e licencës

18.1 ERE mund ta heqë licencën sipas ligjit për energjinë dhe procedurave të përcaktuara në rregulloret e ERE-s, kur:

a) I licencuari kërkon heqjen e licencës;

b) I licencuari shkel kushtet e kësaj licence përfshirë mospagesën e tarifave që kërkojnë në licencë;

c) I licencuari shkel legjislacionin në fuqi;

d) I licencuari deklarohet i falimentuar dhe është i paaftë të përmbushë detyrimet sipas kushteve të kësaj licence;

e) I licencuari e ka marrë licencën me mashtrim.

f) Në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë;

g) Mbaron afati i licencës;

h) Mbaron/shkrihet personi juridik që mban licencën.

18.2 Nëse i licencuari ndryshon statusin e tij ligjor ose aksionari kryesor ndryshohet pa miratimin nga ERE, licenca bëhet e pavlefshme dhe anulohet dhe pasuesi i të licencuarit do të aplikojë për një licencë të re sipas procedurës së ERE-s për dhënie licence.

18.3 I licencuari është i detyruar të kryejë veprimtaritë e specifikuar në licencë. Nëse gjatë kryerjes së veprimtarisë së licencuar, shfaqen rrethana për të cilat i licencuari në mënyrë të arsyeshme nuk është në gjendje të kryejë veprimtaritë e specifikuar në licencë, i licencuari do të njoftojë menjëherë ERE-n, dhe do të ndjekë udhëzimet e saj.

18.4 Çdo transferim i kësaj licence pa miratimin e ERE-s do të anulohet dhe do të përbëjë një shkelje të kësaj licence.

18.5 Kur licenca hiqet si pasojë e shkeljeve nga i licencuari të kushteve të licencës, i licencuari do të përgjigjet siç përcaktohet nga ERE, përfshirë kostot lidhur me transferimin e rregullt të licencës te një i licencuar i ri.

18.6 Kur ERE përcakton se i licencuari ka shkelur një ose me shumë kushte të licencës, të



licencuarit do t'i jepet një mundësi e arsyeshme për ta korrigjuar shkeljen para përfundimit të licencës, përveç kur shkelja përfshin kryerjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin të vërtetuara nga organet kompetente.

19. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe e drejta për apel

19.1 Çdo çështje e diskutueshme ose mosmarrëveshje, mes të licencuarit dhe çdo përdoruesi të sistemit të shpërndarjes, lidhur me kushtet e licencës do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve, sipas legjislacionit në fuqi dhe Rregullave të ERE-s.

19.2 Nëse zgjidhja nuk arrihet me mirëkuptim midis palëve, atëherë ERE në bazë të kërkesës të

çdo personi që është palë në këtë mosmarrëveshje, do ta zgjidhë mosmarrëveshjen dhe do të nxjerrë vendimin e saj sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullave të ERE-s.

19.3 I licencuari mund t'i apelojë vendimet e ERE-s sipas legjislacionit në fuqi. Pas ezaurimit të ankimit administrativ, vendimi mund të ankimohet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 ditëve nga publikimi i vendimeve në Fletoren Zyrtare.

19.4 I licencuari duhet të zbatojë vendimet e ERE-s në pritje të shqyrtimit para Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, vetëm në rast se nuk pezullohet ky vendim nga Gjykata.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Enti Rregullator i Energjisë

LICENCË

PËR VEPRIMTARINË

E OPERIMIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

Licenca i jepet:

(Emri i plotë i të licencuarit)

Seria: _____

Nr. i licencës: _____

Data e hyrjes në fuqi të kësaj shtojce: _____

VENDIM

Nr. 184, datë 20.8.2018

MBI MIRATIMIN E “KONTRATËS PËR SIGURIMIN E SHËRBIMEVE TË BALANCIMIT (KAPACITETIT REZERVË DHE ENERGJISË BALANCUESE), TË SISTEMIT ELEKTROENERGJETIK PËR PERIUdhËN KOHORE 1.1.2018–31.12.2018” MIDIS OST SHA DHE KESH SHA

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” ,i ndryshuar; VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do

të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; “Rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017, si dhe nenit 19 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.8.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike në lidhje me “kontratën për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektro-



energjetik për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018 midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.”,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 1740/2 prot., datë 30.3.2018, shoqëria KESH sh.a. ka dërguar në ERE kërkesën për miratimin e Kontratës me nr. 1740/1, datë 29.3.2018 për shoqërinë KESH sh.a. dhe nr. 2358 prot., të shoqërisë OST sh.a., “Për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektroenergjetik”, për periudhën 1.1.2018–31.12.2018, të nënshkruar nga shoqëritë OST sh.a. dhe KESH sh.a.

- Enti Rregullator i Energjisë në bazë të nenit 20 germa “h” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ka autoritetin për të miratuar kushtet e përgjithshme të kontratave për shërbimet e rregulluara, të ofruara nga pjesëmarrësit e tregut, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik;

- ERE, me vendimin nr. 102, datë 30.4.2018 vendosi “Fillimin e procedurës për miratimin e “Kontratës për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektroenergjetik për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018” midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.”.

- Enti Rregullator i Energjisë, me anë të shkresës me nr. 384 prot., datë 11.5.2018, kërkoi opinionin e palëve të interesit si OST sh.a., KESH sh.a., Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës.

- Pas përfundimit të afatit 15-ditor për marrjen e opinionit apo komenteve të të interesuarve në lidhje me këtë marrëveshje, rezultoi se nuk është përcjellë në ERE asnjë opinion mbi këtë kontratë.

- ERE, në datën 6.7.2018, organizoi një seancë dëgjimore me qëllim dhënien e një opinionit dhe shpjegimeve mbi përmbajtjen e nenit 7 “Detyrimet e OST-së”, pikën 7.3, ku thirri palët e interesit si OST sh.a., KESH sh.a., Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës.

- OST sh.a., në korrespondencë zyrtare ka bërë me dije se shërbimet ndihmëse dhe të balancimit mund të sigurohen vetëm nga njësitë gjeneruese në kaskadën e lumit Drin, Fierzë dhe Vau i Dejës. Subjektet e tjera, të cilët kanë ndërtuar njësi gjenerimi të energjisë elektrike nuk

kanë të instaluar pajisjet e nevojshme për të realizuar këtë proces. OST sh.a. bën me dije se KESH sh.a. është siguruesi më eficient dhe konstant i energjisë elektrike për qëllimet sa më sipër shpjeguar, e që nuk rëndon në rritjen e kostove të OST sh.a.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), me shkresën nr. 3752/1 prot., datë 26.12.2017, në referencë të nenit 62.1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, Operatori i Sistemit të Transmetimit prokuron energjinë elektrike për të mbuluar humbjet në rrjet, shërbimet e balancimit ose ato ndihmëse të nevojshme për funksionimin e sistemit, nëpërmjet një procedure konkurruese, jodiskriminuese dhe transparente, duke iu përmbajtur parashikimeve ka sugjeruar që çmimi i vendosur sipas rregullave të tregut për sa i përket kontratës dypalëshe për sigurimin e shërbimit të balancimit dhe shërbimeve ndihmëse ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a., duhet të bazohet në çmimin mesatar vjetor të ditës në avancë (DAM) të bursës hungareze HUPX në momentin e nënshkrimit të kontratës dypalëshe.

Sa më sipër referuar, evidentojmë se çmimet dhe tarifat në këtë kontratë janë të dakordësuara nga palët në mbështetje edhe të udhëzimit të MIE-s dhe nuk janë objekt i miratimit nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kontratën, “Për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektroenergjetik për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018” midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.”. (Bashkëlidhur këtij vendimi.)

2. Çmimet dhe tarifat e përmendura në këtë kontratë nuk janë objekt i miratimit nga ERE.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë KESH sh.a. dhe OST sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**KONTRATË**

PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË
BALANCIMIT

(Kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese)
NDËRMJET

**OPERATORIT TË SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT SHA**

(më poshtë referuar si “OST” sh.a.)

Adresa: Autostrada Tiranë–Durrës, km 9,
Yrshek, Kashar, Tiranë

DHE

KORPORATËS

ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE

(më poshtë referuar si KESH sh.a.)

Adresa: Rruga “Eshref Frashëri”, nr. 8,
Kompleksi Vizion, Tirane

**OST sh.a. dhe KESH sh.a. më poshtë
referuar si “Palët”**

Tiranë, _____2018

Baza ligjore

Baza ligjore për hartimin dhe nënshkrimin e kësaj kontrate është:

a) Ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”;

b) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2015, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar;

c) Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 139, datë 25.8.2016, “Mbi rregullat e përkohshme të tregut të energjisë elektrike”;

d) Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017, “Mbi miratimin e Rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike”;

e) Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, “Mbi miratimin e Kodit të Transmetimit”;

f) Vendimet nr. 23, datë 25.3.2009 dhe nr. 34, datë 13.5.2014, me të cilat Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka vendosur rinovimin përkatësisht të licencave për prodhimin dhe tregtimin e energjisë elektrike, për KESH sh.a. (ndryshuar me vendimin nr. [97, datë 17.6.2016, “Mbi miratimin e licencës së tregtimit të energjisë](#)

[elektrike”](#) dhe [vendimin nr. 99, datë 17.6.2016, “Mbi miratimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike”](#);

g) Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a.”;

h) Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 134, datë 6.9.2017 “Mbi licencimin e Shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit OST sh.a., në aktivitetin e Operimit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike”.

Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

Përveç rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë kontrate ose kur konteksti e kërkon ndryshe, të gjithë termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin e përcaktuar në këto përkufizime:

“**Kontratë**” do të thotë kjo kontratë dhe të gjitha ndryshimet që mund t’i bëhen kësaj kontratë së bashku me anekset dhe çdo dokumentacioni bashkëlidhur.

“**Data e fillimit**” do të thotë dita nga e cila kontrata fillon të bëhet efektive.

“**Muaji**” do të thotë muaji kalendarik.

“**Viti**” do të thotë viti kalendarik.

“**Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. ose “OST”** është personi juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit të sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.

“**Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. ose “KESH”** është personi juridik i licencuar nga ERE për prodhimin dhe tregtimin e energjisë elektrike.

“**Enti Rregullator i Energjisë**” ose “**ERE**” është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin për sektorin e energjisë dhe ligjin për sektorin e gazit.

“**Sistem i Transmetimit**” është sistemi i përdorur për transmetimin e energjisë elektrike në tension të lartë dhe shumë të lartë, i lidhur në paralel me sistemet e vendeve të tjera, që përfshin midis të tjerave linjat, strukturat



mbështetëse, pajisjet transformuese dhe kyçëse/shkyçës për lëvrimin e energjisë elektrike te klientët ose në rrjetin e shpërndarjes, pa përfshirë furnizimin.

“Sistemi i energjisë elektrike” është një sistem i ndërlidhur, i përbërë nga centralët elektrike, linjat elektrike, nënstacionet dhe pajisjet e transmetimit dhe shpërndarjes, me qëllim transmetimin apo shpërndarjen e energjisë elektrike te klientët.

“Pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike” është një person juridik, i regjistruar si pjesëtar i tregut të energjisë elektrike, që përfshin prodhuesit, tregtarët, furnizuesit, klientët, Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, sistemet e mbyllura të shpërndarjes dhe operatori i tregut. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes janë pjesëmarrës të tregut të energjisë elektrike vetëm për qëllim të sigurimit të energjisë elektrike të nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet, balancimin dhe shërbimet ndihmëse.

“Rezerva e mbajtjes së frekuencës (FCR)” është ajo rezervë që në rast të devijimit të frekuencës nga vlerat e lejuara, aktivizohet automatikisht dhe plotësisht brenda 30 sekondave, duke vazhduar të jetë efektive për rreth 15 minuta, nëpërmjet kontrollit automatik RASH (Rregullatori Automatik i Shpejtësisë) të çdo agregati që mbahet vazhdimisht në punë.

“Rezerva e restaurimit të frekuencës (FRR)” është rezerva e rivendosjes së frekuencës.

“Rezerva zëvendësuese (RR)” është rezerva e rregullimit terciar, e cila aktivizohet manualisht sipas kërkesës së Operatorit të Transmetimit, në rast se vihet re aktivizim i vazhdueshëm i rezervës FRR deri në limitet e paracaktuara. Qëllimi kryesor i rezervës terciare është të çlirojë rezervën FRR dhe ta kthejë në gatishmëri për aktivizimin e radhës, si dhe të përdoret si rezervë suplementare për rezervën FRR kur shfaqet një incident në sistemin elektroenergetik. Koha e aktivizimit të rezervës RR është 15 minuta nga kërkesa e bërë nga operatori i QDK.

“Kapacitet rezervë në ngritje/ulje” është kapaciteti rezervë FRR dhe RR.

“Rregullat e përkohshme të mekanizmit balancues” Rregullat e përkohshme për mekanizmin balancues (“Rregullat për mekanizmin balancues”), miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017, mbi miratimin e “Rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike”.

“Mekanizmi Balancues i Energjisë Elektrike” një mekanizëm i operuar nga OST-ja në përputhje me “Rregullat e përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike”.

“Shërbime Ndihmëse” janë shërbimet e nevojshme për operimin e qëndrueshëm të sistemit të transmetimit ose shpërndarjes.

“Shërbimi i Balancimit” është sigurimi i kapacitetit rezervë të kontraktuar dhe/ose energjia balancuese e përdorur nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për të kryer balancimin.

“Ofruesi i shërbimit të balancimit” është një pjesëmarrësi i tregut të energjisë elektrike që siguron shërbimet e balancimit për Operatorin e Sistemit të transmetimit, në bazë të një kontrate për pjesëmarrje në tregun e balancimit, në përputhje me rregullat e balancimit të sistemit elektrik.

“Siguruesi i shërbimeve të balancimit” është një pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike, i cili siguron shërbimet e balancimit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit, bazuar në kontratën për pjesëmarrjen në tregun e balancimit, sipas rregullave të balancimit të sistemit të energjisë elektrike.

“Përfaqësues i Autorizuar” është person i ngarkuar zyrtarisht nga përfaqësuesi ligjor i shoqërive OST sh.a. dhe KESH sh.a. për të garantuar zbatimin e kësaj kontrate.

“Urdhër Operativ” është urdhër që jepet nga Qendra Dispeçer e OST-së në përputhje me këtë kontratë dhe i detyrueshëm për t’u zbatuar nga Qendra Dispeçer e KESH-it. Këta urdhra jepen nëpërmjet telefonit të dedikuar me regjistrim, fonogrameve, faksit dhe mesazheve kompjuterike prej instalimeve SCADA të sistemit elektroenergetik.

“Veprim Operativ” është veprimi që ndërmerret nga Qendra Dispeçer e KESH-it për zbatimin e urdhrat operativ të lëshuar nga Qendra Dispeçer e OST-së në përputhje me këtë kontratë.



Neni 2

Objekti i kontratës

Objekt i kësaj kontrate është ofrimi (shitja) nga ana e KESH-it dhe sigurimi (blerja) nga ana e OST-së e shërbimit të balancimit (kapacitet dhe energji balancuese) që do të përdoret për balancimin e sistemit elektroenergjetik sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.

Neni 3

Detyrimet e KESH sh.a.

3.1 KESH-i merr përsipër të sigurojë shërbimin e balancimit për OST-në, në sasinë dhe kohën e kërkuar nga OST-ja dhe të konfirmuar nga KESH sh.a., sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.

3.2 KESH-i merr përsipër të vendosë në dispozicion kapacitetet rezervë në ngritje/ulje, në masën e kërkuar në avancë nga OST-ja, të cilat aktivizohen vetëm me kërkesë të OST sh.a. dhe për qëllim të balancimit të sistemit elektroenergjetik shqiptar.

3.3 Kjo kontratë për sigurimin e shërbimeve të balancimit për sa konfirmohet nga KESH-i në avancë ka prioritet ndaj të gjitha marrëdhënieve të tjera tregtare të KESH-it.

Neni 4

Shërbimet ndihmëse që sigurojnë gjenerimin/absorbimin e fuqisë reaktive, mbajtjen e niveleve të tensionit

4.1 KESH-i nëpërmjet Qendrës Dispeçer merr përsipër të sigurojë që gjenerimi/absorbimi i fuqisë reaktive, do të garantohet nga njësitë gjeneruese sipas kërkesës së paraqitur nga Qendra Dispeçer e OST sh.a., kërkesë kjo në përputhje me kushtet e lidhjes me Rrjetin e Transmetimit.

4.2 Në bazë të studimeve mbi shpërndarjen e fluksit dhe nivelet e tensionit dhe brenda shërbimit të kontraktuar, Qendra Dispeçer e OST-së udhëzon Qendrën Dispeçer të KESH-it të mbajnë nivele tensioni të specifikuar në pikat e lidhjes së tyre me sistemin e transmetimit.

4.3 Kërkesat minimale për njësitë gjeneruese të KESH-it që do të marrin pjesë në sigurimin e shërbimit të balancimit parashikohen në aneksin 2.

Neni 5

Mundësia për ristartim

5.1 KESH-i merr përsipër të mbajë grupe diesel në të tria centralet e saj, për të mundësuar ristartimet e tyre në mungesë të tensionit në pikën e lidhjes me rrjetin e transmetimit.

5.2 KESH-i duhet të garantojë që grupet diesel në secilin prej centraleve, duhet të jenë në kushte të mira dhe në gatishmëri në çdo kohë, në mënyrë që agregatet të startohen pa prezence tensioni nga sistemi i transmetimit.

Neni 6

Mossigurimi i shërbimeve të balancimit

6.1 Energjia e devijuar përkundrejt interkoneksionin në drejtim ulje/ngritje nga palët përgjegjëse për balancimin, për efekt të zbatimit të mekanizmit të përkohshëm të balancimit do të llogaritet si shërbim balancimi i ofruar nga KESH-i.

6.2 Kompensimi i devijimeve nga programi i shkëmbimit, i livrimit të energjisë në rrjetin interkonektiv ose i tërheqjes së energjisë nga rrjeti interkonektiv, jashtë programit të shkëmbimit, bëhet nëpërmjet programeve të kompensimit, që llogariten nga Qendra Koordinatave e Rajonit, me bazë javore, dhe janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo zonë kontrolli (OST), për t'u livruar/tërhequr nga rrjeti interkonektiv, sipas tarifave (blloqe orare) të ENTSO-E.

6.3 OST sh.a. pas marrjes së njoftimit, do t'i bëjë me dije/dërgojë KESH sh.a. programin e kompensimit të devijimeve nga programi i shkëmbimit, i livrimit të energjisë elektrike të llogaritur nga Qendra Koordinatave e Rajonit sipas tarifave (blloqe orare) të ENTSO-E.

6.4 KESH-i është përgjegjëse për mbulimin e programeve të kompensimit të OST-së me interkoneksionin pa kosto shtesë.

Neni 7

Detyrimet e OST-së

7.1 OST-ja do të dërgojë në KESH kërkesën (skedulin) mujore me treguesit për kapacitetin rezervë në ngritje/ulje të kërkuar jo më vonë se 10 ditë përpara fillimit të muajit për muajin pasardhës.



7.2 KESH-i, referuar kërkesës (skedulit) mujor të dërguar nga OST-ja për muajin pasardhës, jo më vonë se 8 ditë përpara fillimit të muajit do t'i dërgojë OST-së konfirmimin mbi mundësinë e sigurimit të kapacitetit rezervë në ngritje/ulje të kërkuar nga OST-ja për muajin pasardhës.

7.3 OST-ja bazuar në konfirmimin e bërë nga KESH-i për muajin pasardhës, jo më vonë se ora 12:00 e ditës së premte të çdo jave, do t'i dërgojë KESH-it kërkesën (skedulin) javor me treguesit indikativ të kapacitetit rezervë në ngritje/ulje të kërkuar për javën pasardhëse. KESH-i referuar kërkesës së OST sh.a. për javën pasardhëse, jo më vonë se ora 14:00 e së njëjtës ditë, do t'i dërgojë OST sh.a. konfirmimin mbi mundësinë e sigurimit të kapacitetit rezervë kërkuar nga OST-ja për javën pasardhëse.

7.4 Kërkesa (skeduli) i dërguar nga OST sh.a. do të përmbajë, treguesit e kapacitetit të rregullimit në ngritje/ulje në mw me bazë orare për ditën e mesatarizuar të javës pasardhëse. Ky skedulim është i vlefshëm për të gjitha ditët e javës pasardhëse.

Neni 8

Kontrolli, monitorimi dhe testimi

Aktivitetet e kontrollit monitorimit dhe testimit për njësitë gjeneruese, që do të marrin pjesë në sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe monitorimi i kapacitetit rezervë do të bëhet nëpërmjet sistemit SCADA që administrohet vetëm nga OST sh.a.

Neni 9

Çmimi për sigurimin e shërbimit të balancimit (kapacitet dhe/ose energji balancuese)

9.1 Çmimi për sigurimin e kapacitetit të rezervës së restaurimit të frekuencës në drejtim ngritje/ulje është 270 lekë/mw/h.

9.2 Çmimi për sigurimin e kapacitetit të rezervës zëvendësuese (RR) është 400 lekë/mw/h.

9.3 Çmimi i ofrimit të energjisë balancuese është ai i miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017, mbi miratimin e “Rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike”.

Neni 10

Matja dhe faturimi i shërbimit të balancimit (kapacitet rezervë)

10.1 KESH sh.a., bazuar në të dhënat për kapacitetin e kërkuar nga OST-ja dhe të siguruar KESH sh.a. (nominuar) për secilën javë të muajit objekt faturimi, brenda ditës së dytë (2) të punës së çdo muaji, për muajin paraardhës të sigurimit të shërbimit të balancimit (kapacitetit rezervë), do t'i dërgojë OST-së faturën paraprake e cila do të përmbajë shumën e kapaciteteve orare të mesatarizuara për 24 orë (ditore) të kërkuar dhe konfirmuar nga palët respektivisht për kapacitetin rezervë në ngritje/ulje për muajin përkatës, çmimin respektiv të kapacitetit rezervë në ngritje/ulje, siç parashikohet në nenin 9 dhe vlerën totale të shërbimit të siguruar nga KESH-i për periudhën në fjalë.

10.2 KESH sh.a. brenda ditës së 8 (tetë) të punës të çdo muaji, për muajin paraardhës, do të përgatisë dhe dërgojë në OST faturën tatimore për shërbimin e balancimit (kapacitetit rezervë në ngritje/ulje) të siguruar për OST-në për periudhën objekt faturimi.

10.3 Kursi i këmbimit për konvertimin e euro (EUR) në lek shqiptar (ALL), do të jetë ai i datës së lëshimit të faturës tatimore sipas kursit të publikuar nga Banka e Shqipërisë në: www.bankofalbania.org

Neni 11

Matja dhe faturimi i shërbimit të balancimit (energjisë balancuese)

11.1 Energjia balancuese e aktivizuar si shërbim balancues paraqet shumën e energjisë aktivizuar nga të gjitha njësitë balancuese të grupit përgjegjës për balancë. Energjia balancuese e aktivizuar përcaktohet duke u bazuar në kërkesën për aktivizim nga OST-ja dhe/ose nevojën për balancim të sistemit dhe si e tillë konsiderohet ndryshim në skedulin e palës përgjegjëse për balancim.

11.2 Llogaritja dhe faturimi i shërbimit të balancimit (energjisë balancuese) bëhet në bazë të matjes së energjisë orare nga qendra e menaxhimit të energjisë në OST, për çdo agregat/central dhe në total për centralet e KESH-it, dhe krahasohet me nominimin me bazë orare të deklaruar nga KESH-i.



11.3 Diferenca ndërmjet matjes së energjisë dhe nominimit, për çdo orë, do të konsiderohet si energji balancuese nëse justifikohet me kërkesën e bërë nga OST-ja për ngritje/ulje të gjenerimit në mënyrë automatike dhe manuale dhe/ose rezulton se ka shërbyer për balancimin e sistemit në kushtet kur KESH sh.a. është ofrues i vetëm i shërbimit të balancimit dhe mbulon programet e kompensimit me interkoneksionin.

11.4 OST-ja brenda ditës së 5 (pestë) të punës të muajit pasardhës të ofrimit të shërbimit të balancimit do t'i dërgojë KESH sh.a. të dhënat e detajuara mbi shërbimin e balancimit (energjinë balancuese) të ofruar nga KESH-i. Bazuar në të dhënat që rakordohen ndërmjet OST-së dhe KESH-it brenda ditës së 7 (shtatë), palët brenda ditës së 8 (tetë) lëshojnë faturat përkatëse të shërbimit të balancimit (energjisë balancuese) nga ku OST-ja faturën për shërbimet ndihmëse (energjinë balancuese) në ulje dhe KESH sh.a. për shërbimet ndihmëse (energjinë balancuese) në ngritje.

11.5 Kursi i këmbimit për konvertimin e euro (EUR) në lek shqiptar (ALL), do të jetë ai i datës së lëshimit të faturës tatimore sipas kursit të publikuar nga Banka e Shqipërisë në: www.bankofalbania.org

Neni 12

Pagesa e shërbimit të balancimit (kapacitet rezervë dhe energji balancuese)

12.1 Sipas rastit, palët do të kryejnë pagesat kundrejt vlerave të faturave mujore përkatëse për shërbimin e balancimit brenda ditës së 30 të muajit kalendarik në të cilën është lëshuar secila prej faturave.

12.2 Vonesa në kryerjen e pagesës: nëse palët dështojnë të kryejnë pagesat brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë, shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës, do të jetë ai i parashikuar në ligjin nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare”, i ndryshuar.

Neni 13

Mosperformanca për shkak të forcës madhore

13.1 Përveçse kur specifikohet ndryshe në këtë kontratë, “forca madhore” për qëllimet e kësaj kontrate do të thotë një ngjarje jashtë

kontrollit të arsyeshëm të një pale që e pengon atë palë të realizojë disa ose të gjitha detyrimet e kësaj kontrate. Ngjarjet e forcës madhore do të përfshijnë pa kufizim:

a) Një ngjarje ose një akt natyror ose shoqëror që ndodh në vend, si: tërmetet, ciklonet, rrufetë, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret, lufta, konfliktet e armatosura, kryengritjet, aktet terroriste, të cilat pengojnë secilën palë të përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj kontrate, si dhe akte ose ngjarje të tjera, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të një pale dhe nuk ndodhin për faj të saj dhe që pala nuk është në gjendje t'i eliminojë ato, edhe pse ka ushtruar siç duhet aftësitë, përpjekjet dhe kujdesin e saj, si dhe rastet e parashikuara nga neni 90, i ligjit nr. 43/2015, datë 30.4.2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

13.2 Nëse një palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të forcës madhore, në kryerjen e detyrimeve të saj për lëvrin dhe pranim sipas kësaj kontrate dhe kjo palë respekton kërkesat e pikës 13.3 të këtij neni, do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e Palës Pretenduese dhe ajo do të çlirohet nga këto detyrime për atë periudhë kohore që kjo forcë madhore e pengon performancën e saj. Asnjë detyrim për të paguar dëmet (zhdëmtimet për paaftësinë për lëvrin dhe pranim) nuk do t'i kërkojë dhe merret Palës lidhur me sasi të palëvruara respektivisht të pamarrë si rezultat i forcës madhore.

13.3 Sa më shpejt që të jetë e mundur, pasi konstaton forcën madhore Pala që kërkon përjashtim nga detyrimet e veta, do të njoftojë Palën tjetër për ngjarjen e forcës madhore dhe, për aq sa është e mundur do t'i sigurojë një vlerësim jodetyrues mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj performuese. Pala Pretenduese do të përdorë gjithë përpjekjet ekonomikisht të favorshme dhe të ligjshme për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe gjatë vazhdimit të forcës madhore, do t'i sigurojë Palës tjetër të dhëna të përditësuara, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë performuese.



Neni 14

Zgjidhje e mosmarrëveshjeve dhe ligjet e zbatueshme

14.1 Për çdo gjë të pashprehur në këtë kontratë, palët do t'i referohen dispozitave të legjislacionit që rregullojnë sektorin e energjisë elektrike.

14.2 Kjo kontratë do të zbatohet në përputhje me të gjitha aktet normative me fuqi juridike në territorin e Republikës së Shqipërisë.

14.3 Në rast të lindjeve të mosmarrëveshjeve gjatë zbatimit të kësaj kontrate, përfaqësuesit e autorizuar për çdo Palë, do të tentojnë me mirëbesim të zgjidhin mosmarrëveshjen sa më shpejt që të jetë e mundur. Në qoftë se përfaqësuesit arrijnë ta zgjidhin mosmarrëveshjen, zgjidhja do t'iu njoftohet Palëve me shkrim dhe do të jetë detyruese për ato. Në qoftë se përfaqësuesit nuk mund ta zgjidhin mosmarrëveshjen brenda një afati kohor të arsyeshëm por jo më të gjatë se 40 (dyzetë) ditë kalendarike, ose në qoftë se një Palë nuk arrin të zgjedhë një përfaqësues, brenda 10 (dhjetë) ditësh kalendarike nga njoftimi me shkrim i ekzistencës së mosmarrëveshjes, atëherë secila prej Palëve ka të drejtë t'i drejtohet ERE-s, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

14.4 Secila palë ka të drejtë që, që nga dita që ka marrë njoftim për vendimin e ERE-s, t'i drejtohet gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 15

Ndryshimet

Kjo kontratë mund të ndryshohet vetëm me një dokument të shkruar të firmosur nga të dyja Palët dhe të miratuar nga ERE.

Neni 16

Klauzola përfundimtare

Palët bien dakord që:

i. do të ndërmarrin të gjitha veprimet që janë të arsyeshme, në mirëbesim dhe të nevojshme për të siguruar vijimësinë e shërbimit dhe aplikimit të kësaj kontrate;

ii. do të negociojnë dhe të rishikojnë këtë kontratë kur është e nevojshme për t'u përshtatur me të gjitha ndryshimet në aktet normative me fuqi juridike në territorin e Republikës së Shqipërisë; dhe

iii. përveç rasteve kur përshkruhet ndryshe në këtë kontratë të ruajnë siç parashtrahet në këtë kontratë, të mos e ndërpresin ose të pezullojnë përmbushjen e ndonjë detyrimi si rezultat i ndonjë vendimi në pritje për ndonjë debat ndërmjet palëve.

Neni 17

Hyrja në fuqi dhe afati i zbatimit të kontratës

17.1 Kjo kontratë nënshkruhet nga palët dhe hyn në fuqi pas miratimit nga ERE.

17.2 Kjo marrëveshje i shtrin efektet e saj nga data 1.1.2018 (data e fillimit), deri në datën 31.12.2018 (data e përfundimit).

Kontratat hartohen në 3 (tri) kopje origjinale, nga një për secilën palë dhe një për ERE-n.

Për:
KORPORATËN
ELEKTROENERGJETIKE
SHQIPTARE, KESH SHA
ADMINISTRATORI
Agron Hetoja

Për:
OPERATORI I
SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT,
OST SHA
ADMINISTRATORI
Klodian Gradeci

ANEKSI 1

Palët bien dakord që rezerva mbajtjes së frekuencës (FCR), rezerva restaurimit të frekuencës (FRR) do të sigurohen nga KESH sh.a. duke përdorur burimet e mëposhtme. KESH sh.a., do të bëjë përpjekjet e tij më të mira, që gjatë kohëzgjatjes së kontratës do të sigurojë shërbimet ndihmëse sipas tipit, sasisë dhe cilësisë sipas kërkesës së OST sh.a.

1. Rezerva e mbajtjes së frekuencës (FCR) vendoset në të gjitha agregatet e lidhur direkt me Rrjetin e Transmetimit, në mënyrë sa me uniforme dhe proporcionale që të jetë e mundur. Njësitë gjeneruese duhet të jenë të pajisura me Rregullator Automatik të Shpejtësisë (RASH). Saktësia e matjes së frekuencës për rregullimin primar duhet të jetë më e mirë ose e barabartë me 10 mHz. Intervali i mos ndjeshmërisë së rregullatorit të njërive gjeneruese nuk duhet të kalojë ± 10 mHz. Aktivizimi i Rregullimit Primar në njësitë gjeneruese fillon para se devijimi i frekuencës të kalojë ± 20 mHz (që është shuma e saktësisë së matjes së frekuencës dhe intervali i mosndjeshmërisë së rregullatorit. Sipas planifikimit vjetor që bëhet nga ENTSO-E,



kontributi i zonës sonë të kontrollit në rregullimin primar për vitin 2017 është 6 mw, nga 3000 mw, që është rezerva totale e këtij rregullimi për rrjetin sinkron të ENTSO-E, dhe konstantja e vendosur në rregullatore (karakteristika fuqi-frekuencë e rrjetit) 51 mw/Hz, nga 27002 mw/Hz që është konstantja totale e rrjetit sinkron. Në rastin kur sistemi elektroenergjetik punon i izoluar nga sistemet fqinje, rezerva minimale e rregullimit primar vendoset jo më e vogël se 5% e ngarkesës totale të sistemit.

2. Rezerva e restaurimit të frekuencës aFRR përdoret (në mënyrë automatike) në rast të devijimit të frekuencës nga vlera nominale dhe/ose të balancës së shkëmbimit nga vlera e programuar. Kjo rezervë vendoset në agregatat/centralin rregullues të destinuar për këtë qëllim. Sipas Manualit Operacional të ENTSO-E (Policy 1), për llogaritjen e kësaj rezervë, në mënyrë orientuese, përdoret formula e mëposhtme:

$$R = \sqrt{aL_{\max} + b^2} - b, \text{ ku } a = 10, b = 150,$$

dhe L është ngarkesa e konsumit.

Tipi i Rezerves	1	2	3 ...	19	20	21	22	23	24	Mesatare
FRR+	22	21	20	68	74	68	60	47	37	48
FRR-	37	36	35 ...	43	44	43	40	37	32	37
RR+	70	70	70 ...	70	70	70	70	70	70	70
RR-	10	10	10 ...	10	10	10	10	10	10	10

ANEKSI 2

Çdo njësi gjeneruese që merr pjesë në sigurimin e shërbimeve ndihmëse minimumi duhet të ketë aftësitë e mëposhtme:

i. të gjenerojë dhe të operojë me parametra normalë për frekuenca të sistemit të transmetimit në diapazonin 49.5 Hz–50.5 Hz;

ii. të mbetet e sinkronizuar me sistemin e transmetimit për frekuenca në sistemin e transmetimit në diapazonet 47.5 Hz–49.5 Hz dhe 50.5 Hz–52.5 Hz për një kohë prej 60 minutash;

iii. të mbetet e sinkronizuar me sistemin e transmetimit për frekuenca në sistemin e transmetimit në diapazonet 47.0 Hz–47.5 Hz për një kohë prej 20 sekonda. Kjo kërket për çdo herë që frekuenca është nën 47.5 Hz;

Rezerva restaurimit të frekuencës automatike shfrytëzon në mënyrë të centralizuar dhe të vazhdueshme rregullimin automatik të gjenerimit, duke modifikuar pikën e punës të fuqisë aktive të njësive gjeneruese, për një periudhë kohë që fillon pas disa sec e deri në 15 min pas incidentit. Saktësia e matjes së frekuencës për këtë rregullim duhet të jetë ndërmjet 1.0 mHz dhe 1.5 mHz.

Në tabelën e mëposhtme jepen centralet dhe kapaciteti i instaluar i njësive gjeneruese, të cilat do të sigurojnë shërbimet ndihmëse për sistemin elektroenergjetik.

CENTRALI	KAPACITETI INSTALUAR (mw)
Fierze	4 X 125
Koman	4 X 150
Vau i Dejës	5 X 50

Më poshtë në tabelë tregohet alokimi i kapacitetit të rezervës FRR, sipas të dy drejtimeve ngritje/ulje dhe rezervës RR, i cili jepet në tabelën e mëposhtme (shembull ilustrativ):

iv. të mbetet e sinkronizuar me sistemin e transmetimit për frekuenca në sistemin e transmetimit në diapazonet 52.5 Hz–53 Hz për një kohë prej 5 sekonda. Kjo kërket për çdo herë që frekuenca është mbi 52.5 Hz;

v. të mbetet e sinkronizuar me sistemin e transmetimit gjatë ndryshimit të frekuencës në sistemin e transmetimit në vlera më të mëdha dhe të barabarta me 0.5 Hz për sekondë;

vi. të vazhdojë operimin në minimumin e specifikuar të gjenerimit brenda vlerave 49.8 Hz–51.0 Hz;

vii. të mbetet e sinkronizuar gjatë ndryshimit të nivelit të tensionit në sistemin e transmetimit në vlera më të vogël dhe të barabarta me 10%;

viii. të vazhdojë operimin në përputhje me korbën e aftësisë reaktive, siç kërket nga



sistemi i transmetimit për mbajtjen e niveleve të tensionit;

ix. të vazhdojë të mbetet i sinkronizuar gjatë prishjes së balancës gjenerim-ngarkesë sipas standardeve IEC 60034-1;

x. vlera e rrymës së lidhjes së shkurtër duhet të jetë sipas standardeve IEC 60034-1;

xi. gjenerimi minimal: jo më i madh se 50% e kapacitetit nominal;

xii. aftësia për ngritjen e gjenerimit: jo më i

vogël se 1.5% e kapacitetit nominal për minutë, kur njësia është në kushte normale operimi;

xiii. Aftësia për uljen e gjenerimit: jo më i vogël se 1.5% e kapacitetit nominal për minutë, kur njësia është në kushte normale operimi;

xiv. njësitë gjeneruese duhet të vazhdojnë të operojnë dhe kur profilet e tensionit në sistemin e transmetimit janë në nivelet e paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Niveli i tensionit	Lidhur në:	Në kapacitet maksimal $\cos\phi$	Në 50% të kapacitetit maksimal $\cos\phi$
99 kV–123 kV	110 kV	0.93–0.85	0.7–0.4
90 kV–100 kV		0.85	0.7–0.4
140 kV–163 kV	150 kV	0.93–0.85	0.7–0.4
125 kV – 140 kV		0.85	0.7–0.4
198 kV–242 kV	220 kV	0.85–0.93	0.7–0.4
190 kV–200 kV		0.85	0.7–0.4
360 kV–420 kV	400 kV	0.93–0.85	0.7–0.4
350 kV– 360 kV		0.85	0.7–0.4

ANEKSI 3

Formati i skedulimit vjetor, mujor, dhe ai javor që do të përdoret si bazë për llogaritjen e kapacitetit rezervë.

Energjia e mesatarizuar për orën përkatëse të urdhrit të dhënë nga OST-ja për ngritje ose ulje të gjenerimit, në kuadrin e rregullimit automatik dhe manual sipas kësaj Marrëveshje përmbledhtazi do të llogaritet sipas formulës:

$\Sigma P_{reg} = \Sigma P_{ngritje/ulje, auto} + \Sigma P_{ngritje/ulje, manual}$

- $\Sigma P_{ngritje/ulje, auto}$ - kërkesa për rregullim automatik për njësitë gjeneruese, të cilat janë nën kontrollin fuqi-frekuencë.

$\Sigma P_{ngritje/ulje, manual}$ - Kërkesa për rregullim manual do të bazohet në urdhrat e lëshuar, sipas hierarkisë, QDK (OST) --> KESH. Urdhrat do të dokumentohen sipas formatit të aneksit 4. Në çdo rast pas dhënies së urdhrit nga QDK-ja duhet konfirmuar ekzekutimi tij nga ana e KESH-it (me kërkesë për rregullim manual kuptohet aktivizimi i rezervës së zëvendësimit

- Aktivizimi i rezervës së restaurimit automatik (FRR).

Për qëllime të përlogaritjes së aFRR, do të përdoren të dhënat e përfthuara nga sistemi kontrollit fuqi-frekuencë (LFC) instaluar në Qendrën Dispeçer Kombëtare të OST sh.a. Duke qenë se ky sistem është unik, të dhënat e përfthuara nga ky sistem do të konsiderohen të pakontestueshme duke qenë se aktualisht nuk ka një sistem tjetër për të kontestuar të dhënat e përfthuara nga ky sistem. Çdo ditë OST sh.a. do të ekstraktojë të dhënat e një dite më parë mbi pikat e punës për gjeneratorët, të cilët kanë qenë të aktivizuar për dhënien e aFRR. Përfshihet dita e shtunë dhe e diel, të cilat janë ditë pushimi dhe të dhënat për këto ditë do të ekstrahohen ditën e hënë të javës pasuese.

- Llogaritja e rezervës së restaurimit të frekuencës automatike (FRR) do të jetë si më poshtë:

$$C = \text{matja-kërkesë} = B - (A - D)$$

$A \rightarrow$ Kërkesa për aFRR (*set point*), do të llogaritet si mesatare algjebrike e pikave të punës të dërguara çdo 4s nga LFC.


$$A = \frac{\sum_{i=1}^n \text{set point}_i}{n}$$

B → Energjia e prodhuar nga njësia/njësitet që kanë ofruar aFRR, me P shprehet fuqia.

$$B = \frac{\sum_{i=1}^n P_i}{n} * \frac{1}{900}$$

C → Energjia e prodhuar si pasojë e aktivizimit të FRR (kontributi FRR)

D → Skedulimi i njësive/njësive në ditën avancë në kuadër të kontratave jashtë objektit të kësaj marrëveshje.



ANEKSI 4

Drejtuar: Dispeçeria KESH sh.a.

B. Subjekti: Kërkesë për aktivizim të rezervës zëvendësuese (RR) në kaskadën e Drinit

Ne përputhje me marrëveshjen për “Sigurimin e shërbimit të balancimit” kërkohet vënia në punë e kapacitetit gjenerues të energjisë elektrike në centralët e kaskadës së Drinit sipas specifikimeve të mëposhtme:

- Intervali orar: _____
- Sasia: **X mw**
- Drejtimi: **ngritje/ulje**
- Koha maksimale e lejuar për aktivizim: **15_min.**

Jeni të lutur të konfirmoni ekzekutimin e kërkesës sa më sipër.
Faleminderit për bashkëpunimin.

**Qendra Dispeçer Kombëtare
OST sh.a.**

**VENDIM****Nr. 185, datë 20.8.2018****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
RINOVIMIN E LICENCËS NR. 73, SERIA
FK08, TË SHOQËRISË “GEN-I TIRANA”
SHPK, NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.8.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Gen-I Tërana” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Gen-I Tërana” sh.p.k., ka aplikuar në ERE për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 524 prot., datë 26.7.2018.

- Objekt i veprimtarisë së këtij subjekti është: tregtim energjie elektrike sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për sektorin e energjisë elektrike, si dhe çdo aktivitet tjetër për shkak dhe të lidhur me objektin e mësipërm.

- Shoqëria “Gen-I Tërana” sh.p.k., zotëron licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike që prej datës 2.12.2008 me vendim të Bordit të ERE-s nr. 129, me seri licence FK08 dhe nr. licence 73. Pas përfundimit të këtij afati, shoqërisë së sipërcituar i është rinovuar licenca në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendim të Bordit të ERE-s nr. 104, datë 1.10.2013.

- Në prag të përfundimit të afatit kohor të licencës, shoqëria “Gen-I Tërana” sh.p.k., kërkon

rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike në bazë të nenit 16, pika 1 (jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, personi mund/duhet të kërkojë në ERE rinovimin e licencës duke paraqitur dokumentet përkatëse) të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Format i dhe dokumentacioni për aplikim është plotësuar nga aplikanti në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar nga aplikanti në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar nga aplikanti pjesërisht pasi rezulton që shoqëria “Gen-I Tërana” sh.p.k., ka depozituar vetëm bilancin e vitit 2017 dhe jo bilancet e tri viteve të fundit siç kërkohet nga neni 9, pika 3, germa “b”, të Rregullores.

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike është plotësuar nga aplikanti në mënyrë korrekte.

- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- dokumentacioni financiar dhe fiskal neni 9, pika 3, germa “b”, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 73, seria FK08, të shoqërisë “Gen-I Tërana” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

**VENDIM****Nr. 186, datë 20.8.2018****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
RINOVIMIN E LICENCËS NR. 74, SERIA
T08P, TË SHOQËRISË “GEN-I TIRANA”
SHPK, NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.8.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Gen-I Tërana” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Gen-I Tërana” sh.p.k., ka aplikuar në ERE për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 523 prot., datë 26.7.2018.

- Objekt i veprimtarisë së këtij subjekti është: tregtim energjie elektrike sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për sektorin e energjisë elektrike, si dhe çdo aktivitet tjetër për shkak dhe të lidhur me objektin e mësipërm.

- Shoqëria “Gen – I Tërana” sh.p.k., zotëron licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike që prej datës 2.12.2008, me vendim të Bordit të ERE-s, nr. 130, me seri licence T08P dhe nr. licence 74. Pas përfundimit të këtij afati, shoqërisë së sipërcituar i është rinovuar licenca në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5 vjeçar me vendim të Bordit të ERE-s, nr. 105, datë 1.10.2013.

- Në prag të përfundimit të afatit kohor të licencës, shoqëria “Gen-I Tërana” sh.p.k., kërkon

rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në bazë të nenit 16, pika 1 (jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, personi mund/duhet të kërkojë në ERE rinovimin e licencës duke paraqitur dokumentet përkatëse) të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Formatit dhe dokumentacioni për aplikim, është plotësuar nga aplikanti në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar nga aplikanti në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar nga aplikanti pjesërisht, pasi rezulton që shoqëria “Gen-I Tërana” sh.p.k., ka depozituar vetëm bilancin e vitit 2017 dhe jo bilancet e tri viteve të fundit siç kërkohet nga neni 9, pika 3, germa “b”, të Rregullores.

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike është plotësuar nga aplikanti në mënyrë korrekte.

- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal neni 9, pika 3, germa “b” do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 74, seria T08P, të shoqërisë “Gen-I Tërana” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

**VENDIM****Nr. 187, datë 20.8.2018**

**MBI REFUZIMIN PËR LICENCIM TË
SHOQËRISË “OBERALD ENERGJITIK”
SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC-et “KRYEZI 3”,
ME FUQI TË INSTALUAR 122.2 kw,
“KRYEZI 4”, ME FUQI TË INSTALUAR
310.7 kw DHE “KRYEZI 5”, ME FUQI TË
INSTALUAR 886.5 kw, ME FUQI
TOTALE 1320 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 41, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 13 dhe 14, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.8.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për refuzimin për licencim të shoqërisë “Oberald Energjitik” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Kryezi 3”, “Kryezi 4” dhe “Kryezi 5”, me fuqi totale 1320 kw,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 154, datë 3.7.2018, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Oberald Energjitik” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë nga HEC-et “Kryezi 3”, me fuqi të instaluar 122.2 kw, “Kryezi 4”, me fuqi të instaluar 310.7 kw dhe “Kryezi 5”, me fuqi të instaluar 886.5 kw, me fuqi totale 1320 kw.

- Me shkresën nr. 55/47 prot., datë 3.7.2018 është bërë njoftimi në media, si dhe me shkresën nr. 422/1 prot., datë 5.7.2018, i është dërguar subjektit “Oberald Energjitik” sh.p.k., kërkesa për plotësimin e dokumentacionit të munguar në dosjen e aplikimit.

- Nga shqyrtimi përfundimtar i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “Oberald Energjitik” sh.p.k., rezulton të mos jenë plotësuar kërkesat e parashikuara në “Rregulloren

për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa “f” (Marrëveshje koncesioni ose autorizimi nga KM-ja në rastet e aplikueshme në përputhje me kuadrin ligjor përkatës). Subjekti ka paraqitur në ERE kontratën koncesionare nr. 10333 rep. dhe nr. 3327 kol., datë 9.9.2013. Me shkresën nr. 85/22 prot., datë 9.6.2015, me anë të së cilës MIE miraton projektin e zbatimit të HEC-ve “Kryezi 3”, “Kryezi 4” dhe “Kryezi 5”, Autoriteti Kontraktues shpreh gatishmërinë për nënshkrimin e kontratës shtesë të Koncesionit ku do të pasqyrohen ndryshimet e parametrave hidroenergjetik në përputhje me projektin e zbatimit. Subjekti ka përcjellë në ERE kërkesat që i ka drejtuar MIE-s për këtë çështje, por jo një kontratë shtesë, duke mos plotësuar kërkesën e Rregullores sipërcituar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). Subjekti ka depozituar në ERE një deklaratë se shoqëria “Oberald Energjitik”, shoqëria “Bekimi Energjitik” dhe shoqëria “Eraldi Energjitik” marrin përsipër të financojnë HEC-et “Kryezi 3”, “Kryezi 4” dhe “Kryezi 5”, deklaratë e cila nuk shoqërohet nga asnjë dokument që vërteton mbështetje financiare duke mos plotësuar kërkesën e Rregullores sipërcituar;

- neni 9, pika 4.1.5, germa “b” (leje nga institucione të tjera). Subjekti ka paraqitur në aplikimin e tij vendimin nr. 1, datë 2.2.2010, të Këshillit të Basentit Ujor Mat, “Dhënie mendimi për përdorim të rezervës ujore për energji elektrike Oberald Energjitik sh.p.k”. Ky dokument nuk konsiderohet si miratim i lejes së përdorimit të ujit, duke mos plotësuar kërkesën e Rregullores sipërcituar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Refuzimin për licencim të shoqërisë “Oberald Energjitik” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Kryezi 3”, “Kryezi 4” dhe “Kryezi 5”, me fuqi totale 1320 kw.



2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM QARKULLUES

Nr. 21, datë 14.9.2018

PËR PËRJASHTIMIN NGA SKEMA DHE REVOKIMIN E CERTIFIKATËS SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE TË BANKËS VENETO SHA, TË PËRTHITHUR NGA BANKA INTESA SANPAOLO ALBANIA SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 28, pika 1, të nenit 30, të nenit 31, pika 6, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 8, pika 3 dhe nenit 9, pika 4, të udhëzimit nr. 3241, datë 18.12.2014, “Për sigurimin e depozitave në banka”, të ndryshuar, të nenit 10, pika 6, të Rregullores, “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të nenit 24, pika 1, shkronja “k”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 20, pika 1, të rregullores, “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, të miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, të nenit 220, pika 3, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 60, datë 6.9.2018, “Për dhënien e miratimit paraprak për bashkimin me përthithje të Bankës Intesa Sanpaolo Albania sh.a., me Bankën Veneto sh.a.”, me propozim të drejtorit të përgjithshëm, Këshilli Drejtues

VENDOSI:

1. Të përjashtojë nga skema e sigurimit të depozitave Bankën Veneto sh.a., të përthithur nga bashkimi me Bankën Intesa Sanpaolo Albania sh.a.

2. Të revokojë certifikatën e sigurimit të depozitave të Bankës Veneto sh.a. Ngarkohet Banka Veneto sh.a., që të dorëzojë në Agjenci certifikatën e sigurimit të depozitave menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a. që të mbajë të veçuara depozitat e siguruar të subjekteve pjesëmarrëse në këtë proces, për një periudhë tremujore nga hyrja në fuqi e revokimit të licencës të Bankës Veneto sh.a., që përkon me çregjistrimin e kësaj të fundit si shoqëri e përthithur në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

4. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare, shpallet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, si dhe në një gazetë kombëtare.

5. Ngarkohen Sektori i Sigurimit dhe Kompensimit të Depozitave, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, Sektori i Financës dhe Investimeve dhe Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm të njoftojë Autoritetin Mbikëqyrës lidhur me këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me çregjistrimin nga Qendra Kombëtare e Biznesit të Bankës Veneto sh.a., si shoqëri e përthithur.

KRYETAR
Donald Duraj

**VENDIM QARKULLUES****Nr. 22, datë 14.9.2018****PËR PËRJASHTIMIN NGA SKEMA DHE
REVOKIMIN E CERTIFIKATËS SË
SIGURIMIT TË DEPOZITAVE TË
BANKËS NBG ALBANIA SHA, TË
PËRTHITHUR NGA BANKA
AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 28, pika 1, të nenit 30, të nenit 31, pika 6, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 8, pika 3 dhe nenit 9, pika 4, të udhëzimit nr. 3241, datë 18.12.2014, “Për sigurimin e depozitave në banka”, të ndryshuar, të nenit 10, pika 6 të Rregullores, “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të nenit 24, pika 1, shkronja “k”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 20, pika 1, të rregullores, “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, të miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, të nenit 220, pika 3 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 61, datë 6.9.2018, “Për dhënien e miratimit paraprak për bashkimin me përthithje të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a., me Bankën NBG Albania sh.a.”, me propozim të drejtorit të përgjithshëm, Këshilli Drejtues

VENDOSI:

1. Të përjashtojë nga skema e sigurimit të depozitave Bankën NBG Albania sh.a., të përthithur nga bashkimi me Bankën Amerikane të Investimeve sh.a.

2. Të revokojë certifikatën e sigurimit të depozitave të Bankës NBG Albania sh.a. Ngarkohet Banka NBG Albania sh.a., që të dorëzojë në Agjenci certifikatën e sigurimit të depozitave menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Banka Amerikane e Investimeve sh.a. që të mbajë të veçuara depozitat e siguruar të subjekteve pjesëmarrëse në këtë proces, për një periudhë tremujore nga hyrja në fuqi e revokimit të licencës të Bankës NBG Albania sh.a., që përkon me çregjistrimin e kësaj të fundit si shoqëri e përthithur në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

4. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare, shpallet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, si dhe në një gazetë kombëtare.

5. Ngarkohen Sektori i Sigurimit dhe Kompensimit të Depozitave, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, Sektori i Financës dhe Investimeve dhe Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm të njoftojë Autoritetin Mbikëqyrës lidhur me këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me çregjistrimin nga Qendra Kombëtare e Biznesit të Bankës NBG Albania sh.a. si shoqëri e përthithur.

**KRYETAR
Donald Duraj**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 336 lekë